

SULEJMAN TRI
KRASNIQI TRI
MOTRA

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32

K 95

TRI NOVELE
HISTORI

814-32

K 195

SULEJMAN KRASNIQI

5

TRI MOTRA
TRI HISTORI

Novelë



1686

1686

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tri plaka po i afroreshin shtëpisë së bardhë me dritare të mëdha. Kur morën kthesën te rrugica që ndante më dysh kopshtin përpara shtëpisë, ato, njëra pas tjetrës, u drejtuan për nga porta.

— A pret mysafirë, o Dan Rrushji! — thirri Havaja, më e vjetra ndër plakat.

Kënga dhe të qeshurat, që zhurmonin brenda në shtëpi, u qetësuan. Në portën e hapur u dukën fytyra të gëzuara.

— Hallat, haaallat e mia! — thirri njëra nga vajzat, dhe u doli përpara.

Plaka e parë hapi krahët, rrudhat në ballë ju sheshuan, e përqafoi të mbesën dhe s'po ngopej së puthuri. Edhe në fytyrën e plakës së tretë gëzimi përmallues nxori krye në buzët, në sytë, në fjalët, në urimet. Kurse plaka e mesit shtrëngoi buzët dhe bërbëliti diçka me vete duke shikuar përdhe, thuase mallëkonte dhëmbët që i kishin rënë.

Vajza e lehtë si flutur që përqafoi të tria hallat vuri re, ose ju duk, sikur halla e mesme në vend që ta përqafonte, ta uronte, foli nën hundë dhe me gishtat si shkarpa shkoze e pickoi me keqdashje në kurrizin e njomë, pastaj ja mori kokën, ja mbështeti në gjoksin e vet rrangall sa përpak ja zuri frymën.

Hallëmadhja dhe hallëvogla u përshëndetën edhe me të tjerët dhe u futën brenda, kurse halla e mesme

kaloi nëpër shtegun që ndante shtëpinë nga kopshti dhe doli prapa. Atje qëndronte si ndonjë stacion i kohës një trung i trashë ftoi të egër dhe drize që ishin ngjitur njësh duke u përdredhur njëri mbi tjetrin. Plakës i lëvizën sytë e vegjël të futur thellë në kafkë. Lëvizi buzët e holla e të vyshkura, përcolli shikimin lart. Një drithmë ja përshkoi kokën e vogël e thatime, pamja ju megjullua: «Të pacipët, shau ajo, si u ka bërë zemra?! Si u ka punuar dora të pritnin degët e drurit të lashtë! Ja, edhe atë degën e trashë, ku i ndjeri babë!..»

Një puih e lehtë bëri që lulet e ftoit të përkëdhelnin njëra-tjetrën, kurse lulet e shëgës me ato buzët e kuqe sikur buzëqeshnin përmes gjethesh e llas-tarësh të harlisur. Dy pellgje u lëngëzuan. Sytë e plakës të futur në rrashtë u njomën. Qepallat e mavijosura u përpëlitën si krahët e ndonjë fluturë të murme nate kur jep shpirt përpara dritës verbuese të llambës elektrike. Plaka shfryu hundët, përplasi mbeturinat andej ku dikur kishte qenë kasollja varfanjake ku ishin lindur dhe rritur bashkarisht me dy kokë dhi. Me cepin e fustanit të zi e të gjatë fshiu sytë, sërishmi shikoi lart: «Asnjë degë të moçme nuk e kanë lënë gjallë! I kanë shartuar! Mirë ajo Drita bishtëpërdredhura, po si ka pranuar ta bënte këtë vëllaziu! Eh, Dan Rrushi, sa keq të morën nëpër këmbë! Si u bërë raje e këtyre mendjefirive!..» bëlbëzoi dëshpërueshëm plaka. Nxori gjuhën si prej ndonjë shpelle të errët, lëpiu buzët e rrudhura që i ngjanin këpurdhës së brymosur.

Në shtëpinë e re bardhoshe — brohoritje. Një turmë të rinjsh dhe të rejash u sulën në rrugë, atje u përqaftuan dhe i dhanë mirëseardhjen një grupi tjetër që kishte me vete instrumenta muzikorë. Një i

ri leshverdhë, zbërtheu fisarmonikën. Tinguj të lehtë u shpërndanë në fillim si shushurimë gjethesh nga era, pastaj u pleksen tinguj të tjerë gjithnjë më të fuqishëm që ngjanin edhe me curielimet e ujqareve të argjenda, edhe me fëshfëritjen e kallinjve të grurit, edhe me cicërimën e zogjve.

Plakës, që po qëndronte si ndonjë pikëçuditëse te vendi ku ngrihej dikur kasollja e tyre, i pikoi në zemër. Ajo vuri mbi gjoks dorën eshtake me pika të murme dhe shtrëngoi vendin ku godiste zemra. Hodhi me frikë shikimin andej nga gazmendi dhe nuk desh t'u besonte syve kur pa në xhadenë e gjerë të katundit të ri dy motrat dhe vëllain e saj duke hequr valle me burra e gra bashkë.

«Përse erdha unë korba!» rënkoi ajo. Nga frika se mos rrëzohej nga të marrurit mend u ul në trungun e gorrices së vjetër që tashmë ishte sharruar e kishte mbetur dy shuplakë mbi sipërfaqe.

Hallëmadhja e pa dhe i tha hallëvoglës:

— Davë!

— Folë, Havë! — ju përgjegj Dava së motrës dhe ja shtrëngoi gishtërinjtë në valle e sipër.

— Davë, shiko Hiqen!

— Ku është?

— Ja, atje ku kemi pasur kasollen, ulur mbi kërcurin e gorrices.

— Ç'bën ajo atje?!

Drita, që udhëhiqte vallen, vuri re shqetësimin e hallave. Ajo e kishte vënë re mënjanimin e Hiqes; ja lëshoi shaminë një të riu valltar, kaloi përmes oborrit dhe u gjet pranë hallës së mesme.

— Largomu sysh! Largohu ti. . . ti. . . besë e preme, vetëpërllyeme, bishtzagare! — i foli me ethe Hiqja vajzës së re.

Drita me të dy duart mbuloi sytë. Asnjëherë nuk i kishte folur njeri në atë mënyrë.

Po plaka e mblodhi veten. E kuptoi që e tronditi vajzën dhe desh të lëpinte atë që pëshytyu.

— Ulu, mbesa e hallës, se një kujtim i zi ma bëri të mugët dritën...

— Cili kujtim, hallë Hiqe? — pyeti Drita pa guxuar ta shikonte në fytyrë.

— I ndjeri gjyshi yt, babai im, — tha plaka duke treguar me dorën si shkarpë pemën dikur ftua i egër dhe drizë e që tani ishte shartuar me ftua të butë dhe shegë — ja, në atë degën e tretë që keni prerë, i ndjeri babai im...

Drita e kishte dëgjuar kushedi sa herë historinë e gjyshit, po, për t'u gjetur në bisedë me hallën që gjithmonë i ishte dukur si ndonjë ugur që bluan në vetëvete gjëra që s'i merr vesh kush, pyeti:

— Ç'ka bërë gjyshi atje, hallë Hiqe?

— S'ditke? Sa keq! Ta kishe ditur, nuk do të ishte siç je, po ndryshe...

Meqë pa se Drita u mat t'ja priste bisedën, u ngut: — Babë Ceni, gjyshi yt, në atë degën e tretë, që e keni përdhosur me filiza të tjerë, u... — Një ngashërim i mbytur ja zuri frymën.

Drita dëgjoi se si fyti i plakës gurgullonte. Ajo u lëndua nga gjendja e hallës, ju afrua, po prapë, si çdo herë, pati frikë ta prekte:

— Përse gjyshi arriti në atë hall?

Plaka ndjeu në zërin e mbesës mallëngjimin dhe aty për aty vendosi ta sulmonte këtë pikë:

— Hava, ime motër, u rrëmbye... Babai atë e kishte fejuar ndër Bajraktarët. Po ajo u krimb në krye, e kryet e krimbur mori erë...

— Pastaj?

— Pastaj Bajraktarët kërkuan nusen. O nusen, o kokën e babait bashkë me kokën e rrëmbyesit. I dhanë afat tre sahat. I ngrati baba! Më pat dashur veçan të gjithëve. Pati besim tek unë. Më mori për dore dhe më futi në kasolle. U tha Bajraktarëve: «Nusen ja ku e keni. Ajo tjetra nuk është më për ju. Nëse nuk mund t'jua sjell kokën e rrëmbyesit, pranojeni timen. Kokën time të thinjur! Tjetër s'kam ç't'ju them...»

Dy burrat e Bajraktarëve më shikuan nga koka e në këmbë. Dolën jashtë dhe biseduan midis tyre. Pastaj më hipën në kalë. Kur u nisën, i thanë plakut:

«Nusen e morëm, po jo atë që patëm zënë, ti vetë na e pate premtuar për borxhin e vjetër. Fytyra na mbeti këtu. Të japim tri ditë afat, o Cen, të na e sjellësh fytyrën...»

— Cili ishte borxhi i vjetër që ua kishit Bajraktarëve? — pyeti Drita. Hiqja krojti kokën. Si u mendua pak, foli:

— Përpara se të lindja unë, kur Hava ishte tre vjeç, familjes i kishte ndodhur një mynxyrë. Tre xhaxhallarët e mi ishin vrarë nga hasmëria. Babai, për t'ju shmangur së keqes, kishte zbritur nga malësia këtu në rrafsh, çifçi në tokën e beut. Mirëpo atë vit kishte plakosur uria, siç tregonte babai. Njerëzit ishin cfilitur saqë edhe kur ngordhte ndonjë bagëti e beut, suleshin dhe grindeshin secili të merrte një copë mish më parë. Nëna shtatzëne, Hava e vogël, shtëpia pa një kokërr misër. Ishin shtrirë në kasolle. Babai si burrë lypsej të bënte hall. Ashtu i këputur urie mori rrugën për të gjetur një grusht drithë hua. Meqë familja jonë kishte qenë e përmendur për trimëri, se shumë herë ishte dalluar në luftë kundër hasmit të vatanit, babai vendosi të tro-

kiste në dyert e dashamirëve. Po ata kishin qenë më keq se ne, kështu e keqja e çoi në derën e Bajraktarëve. Bajraktarët, meqë e dinin gjendjen tonë (e dinin mirë se borxhin s'kishim me se t'ua kthenim), i kërkuan babait gocën, Havën, nëse nuk do ta shlyente borxhin. Halli e shtyu gjyshin tënd që të pranonte kushtin. Koha e keqe nuk na solli në kornak asgjë të mirë përveç hallit dhe varfërisë. Në krye të pesë vjetëve një mushkë drithë që na e kishin dhënë bajraktarët u njëzetfishua, kështu mbeti që Hava të shkonte si nuse në derën e Bajraktarëve. Po nga zemra e Havës qysh në vogli kishte ikur dhëmshuria për prindërit. Ajo bëri atë që nuk e duron as dheu, as kanuni. . . .

— Pastaj, — pyeti Drita — kur të morën Bajraktarët në këmbë të Havës ku të çuan?

— Si të thashë, unë papritur e pa kujtuar u bëra nuse, zura këmbën e sime motër, Havës. Të nesërmen më lajmëruan se babai, atje tek ajo dega e tretë që ju e keni shartuar. . . .

Mbrëmja e freskët si shpirtrat e të rinjve u ndez nga dritat elektrike. Kënga buçiti edhe më me hov. Drita u skuq, u gëzua se atje ku gjendeshin ishte errësirë dhe halla nuk do ta dallonte atë hov gjaku në fytyrën e saj. Nga zhurma dhe hovi që mori kënga, vajza e kuptoi se dhëndrri, i dashuri i saj i zemrës, kishte hyrë në shtëpi. E ndjeu veten më të guximshme:

— Shkojmë brenda — i tha plakës Hiqe.

Kur ju afruan portës, strofa e një kënge si fluturim i një tufe pëllumbash u derdh nga dritaret e hapura:

«Po vijnë plakat me m'pa mue, hoj, dado, hoj, goj' e zemër tue mallëkue, hoj, dado, hoj. . .

Hiqja nguli këmbë te praku si ndonjë mushkë.
Por rryma e një grupi të rejash që po hynin e për-
fshinë edhe atë brenda te dasmorët.

* * *

— Të trashëgohet çifti ri, o Dan Rrushi!

...Të trashëgohen, të trashëgohen!...

— Drita, të trashëgoheni!

— Dritan, të trashëgoheni!

— Faleminderit, — foli Dritani — në kokën e
të pamartuarve.

Hynë dy vajza dhe e morën Dritën në dhomën
tjetër.

— Dasmat e sotme s'po na e bëjnë palmuç ku-
rrizin, o Lim, — i foli Dani një plaku gaztor që po
hiqte llullën në krye të tryezës.

— Po shikoj dhe po mendoj tamam për këtë, eh
ç'kohëra! — foli plaku Lim duke shfryrë tymin e
llullës sikur me atë desh të braktiste gjithë ato an-
dralla që i kishin shkaktuar, përveç të këqijave të
tjera edhe dasmat e tre djemve të vet. Kur ditën e
tretë të dasmës së djalit të madh s'patën as bukë për
të ngrënë, Limi thirri nusen, sikur ajo të kishte faj;
dhe i tha: «Shtrohu në sofër se, ç'patëm, i harxhu-
am për ty, tani do të hamë bukë e nuse».

— E beson, Lim, se edhe kafënë ma kanë kur-
syer — foli Dani dhe e nxori nga bredhja e kujti-
mevet plakun e mirë.

— Kush? — pyeti një plakë andej nga fundi i
dhomës.

— Shoqet dhe shokët e brigadës së Dritës dhe

të Dritanit. Të gjitha i kanë pregatitur vetë.

— Borxhe për të larë, o Dan...

— Po, — foli mendueshëm plaku Lim — po këto shpenzime i ngjajnë shiut. Pika pika, bëhet vija. Kështu asnjeri nuk rëndohet, asnjeri nuk vritet nga ekonomia. Ne përpara na kanë munduar shumë gjëra, midis këtyre edhe padituria.

— Zakoni i ri, në katund të ri, or Dan... Burri shkon te nusja... — hodhi një romuz burri i Hiqes, Zuni i Bajraktarëve.

Dritani në fillim u skuq, shikoi të pranishmit, desh t'i përgjegjej thumbit, po Dan Rrushi, si zot shtëpie që ish, u përgjegj:

— Jetë e re, zakone të reja, — tha ai — iriqët t'i marrësh dhe t'i hedhësh në dyshek, ikin, se ferra kërkon ferrën... Edhe ne kishim gjemba në mendje, po i harrëm, i shkulëm. Drita shkon te Dritani, apo Dritani te Drita, njëlloj është. Unë gjer më sot isha vetë i tretë, kam dy dhoma e një kuzhinë, pas dy muajsh do të jenë gati pallatet që po ndërton kooperativa, kështu që edhe çifti i ri....

— Përse nuk pritën sa t'u jepnin hyrje? — foli i shoqi i Hiqes duke lëmuar syrin e verbër, — apo pranvera ndezi gjakrat dhe... ndoshta Drita ka pasur frikë se mos ai i pari... Ai i pari jua bënte siç ja bënë të ndjerit babait tënd, Cen Rrushit...

— Shtëpia ime ka derën e hapur, o Zuni i Bajraktarëve, fjala e rëndë godet kokën e të zotit që ë lëshon pa frë, pra, nga i ke vënë gishtat, veri thembrat, se ky gazmend kërkon të të shohë kurrizin!..

— Ashtu! — foli Zuni i Bajraktarëve dhe e ngriti faqoren, që e kishte sjellur me vete, me fund. Lëpiu buzët me një të rrotulluar të gjuhës e tha: «Po e çburrënon shumë veten, o Dan Rrushi, s'është pa-

rë ndonjëherë të dëbohet miku, kunati nga shtëpia!
Nëjse, turpi ndjek turpin!.. Epo dhëndurët e rinj
duan vend!.. Helbete, dhëndrri i ri. Vjehrra e re i
do dhëndurët e rinj e të pashëm!..

Dani u nxeh. Bërtiti:

— Jashtë nga konaku im!

— Bëra shaka, o Dan, bëra shaka... Tani s'i
pranoke shakatë!

— Të thashë jashtë nga konaku im!

Zuni uli kokën. Atij i lypsej të qëndronte urtë
e butë, por ja që zemra nuk i duroi. Dy javë kishte
bërë plane të fshehta, qysh kur kishte marrë vesh
që Drita kurrsesi nuk do të martohej me të birin e
vëllait. I vinte të dilte në oborr dhe ta priste gjuhën
e vet llafazane me atë thikën turke që ruante në brez.
Atij i lypsej të qëndronte patjetër aty, bile si dhën-
dërr shtëpie të shpërndante edhe cigare, të vuloste
në gojë buzëqeshjen, po ja që rrebelimi i zemrës
dalldisi gjuhën. Pleqëria përveç të tjerash i kishte
sjellë edhe një huq, paaftësinë për ta përmbajtur
veten.

— Jashtë të thanë! — U sulën dy punëtorë të
rinj.

— Rrini, o djelmosha, unë e kam shtëpinë time
këtu, unë e kam kunat Dan Rrushin, ne jemi tanët,
përse përziheni në punët e të tjerëve? Me Danin bëj
gjithmonë shakara... — Me atë syrin e shëndoshë
shikoi nga e shoqja, e cila ishte kruspullosur në një
qoshe.

«Kisha dëshirë që në këto fytyra të gëzuara të
shikoja lot... Ata lot që aq shumë i dua, se në ko-
hën e sotme gjak s'ka se s'i bën! Ah, gjaku! Etja, je-
ta e shpirtit tim! Tani edhe me lot kënaqem! Por
ja që u nxitova...»

Ndërsa Zuni mendonte, katër të rinj të fuqishëm e mbërthyen për krahësh. Kur e nxorën te porta e sallorit, njëri nga të rinjtë i tha:

— Na ndje, o Zuni i Bajraktarëve, brigada jonë merret me tëharjen, me shkuljen e barërave të këqija. . . Ta marrësh vesh ti, Zuni i Bajraktarëve, ne jo vetëm i shkullim me rrënjë barërat e këqija, po edhe i djegim, po sa për sot, ty të del boll kjo — dhe ja futi një shqelm prapanicave.

Zuni i Bajraktarëve u shkarravit nëpër pluhur, pastaj u ngrit çalë-çalë nëpër terrin e natës duke bluajtur gjëra të hidhura. Kur doli nga katundi i ri, ktheu kokën dhe shikoi nga e kishin përzënë. Ishte fill i vetëm. Errësira ja guduliste shpirtin. Fshati dukej si një anije gjigante me drita verbuese. Mbuloi sytë me duar, lëshoi rrugën, u hodh në grunajë, u përplas përdhe, e qëllonte kokën me grushta dhe bërtiste: «Tersllëqe! Tersllëqe!»

Zuni i Bajraktarëve ishte i verbër në të djathtin, njërin sy e kishte lënë dikur. . .

U zhgërrye sa u zhgërrye në grurin plot lagështi, pastaj ndjeu se si tërë trupi i dridhej si thupra në ujë. Dhëmbët i kërcisnin, s'ishte i zoti ta ndalte kërcëllimën. U shtri në kurriz, po, meqë gjithë jetën i kishte pasur mëri dritat, e nevrikosën yjet. U rikthye përmbys: «Hej, Zenun Bajraktari, — foli dhe u frikësua nga zëri i vet — përse veprove si budalla! Përse në pleqëri u bërë si demi që shemb hendekun me brirë dhe e hedh në kurrizin e vet?! Ç't'u desh, more teveqel! Ç't'u desh, mor matuf?! Zenun Bajraktari, dikur ajka e krahinës, sot dëbohet si ndonjë qen i zgjebosur! Ah, ah, ah!» qau si ndonjë fëmijë. Shkuli bimë plot lagështi, fërkoj gjoksin, qafën, gojën dhe u krodh në mendime.

Nëpër oda, në ndeje, shpeshherë Zuni e kishte dëgjuar gjenealogjinë e familjes së vet. Ishte një kohë kur një pushkë me çark kushtonte një lopë me gjithë viç, ose pesëmbëdhjetë dhi e dy cjepër. Gjyshi i Zunit, Mahmuti, të cilin, përpara se të bëhej bajraktar, e patën quajtur «Gushteri», nga shkaku se vidhte natën (sipas legjendës thuhej se gushteri tërë natën bënte dëme dhe ditën strukej nëpër guva). Mahmuti qysh në rini pat filluar të vidhte vezë e pula të fqinjve, më vonë filloi nga qengjat, delet, viçat e gjer te pendët e zgjedhës. Po, meqë i doli nami për keq e popullata atëhere ishte varfëruar së tepërmi, filloi të merrej me tregëtimin e pushkëve me çark. Ditën në diell futej në ndonjë shtëpi, kur hetonte se burra e gra rropateshin për kafshatën e gojës, merrte pushkët nga gozhdët dhe shkante e i shiste në krahina ku nuk e njihnin. Ndonjëherë edhe vriste ndonjë asqer dhe ja rrëmbente armën. Këto lloj hajdutëri i sillnin fitime të majme. Gushteri për habinë e malësorëve, filloi të mblidhte pasuri dhe askush s'po e merrte vesh se si pasurohej. Ndokush thoshte se Gushteri kishte filluar të vidhte larg trojeve tona, të tjerë përfllisnin sikur Gushteri ishte bërë spiun i turqve e me pagën që merrte për punën e ndyrë po shtonte tufën e bagëtive. Disa mendonin se Gushteri, meqë humbiste me javë e muaj, ishte kthyer në tregëtar Selaniku. Meqë vendi ishte i pushtuar e për shqiptarin një pushkë kushtonte sa mall e gjë, Gushterit po i ecte mbarë tregëtia e armëve; atij as që i bënte përshtypje se ç'fliste bota, ishte nga ata që shikojnë vetëm tymin e oxhakut të vet, pa për të tjerë s'i bënte veshi tërr.

Kur pëlciti kryengritja e fshatarëve në mbarë Shqipërinë, kur gjithë malësorët kapën armët dhe u sulën kundër zaptuesit që po e shtonte zgjedhën me nizamë e taksa të shumëllojshme, Gushteri sapo ishte martuar. E kishte blerë shtrenjtë gruan, po paren e bardhë për ditë të zezë, për këso punësh e kishte mbledhur, siç u thoshte ai malësorëve.

Një natë e thirrën bashkëfshatarët dhe i thanë se të nesërmen lypsej të dilnin e të bashkoheshin te Logu i Burrave me malësorët e tjerë, se do të bënin luftë. Gushteri gjakftohtë u përgjegj: — «Kundër kujt do të bëhet kjo luftë?

— Kundër zaptuesit, o Mahmut — ju përgjegji malësori.

— Në cilin vend do të sulmohet asqeri i pashës? — pat pyetur Gushteri.

— Në grykën e Malit me Borë pritet të vijnë përforcime, ata do t'i sulmojmë ne.

— Në Logun e Burrave, në mos ardhsha, do të më gjeni të gjallë a të vdekur në Grykën e Malit me Borë — tha Gushteri.»

Gjer vonë Gushteri u mor me ca llogari. Ai nuk kishte hartë, po me sforca shtrydhi kujtesën dhe me sytë e mendjes kaloi në gjithë terrenin ku do të zhvilloheshin të nesërmen luftimet. E pa të udhës të shkonte pa zbardhur dita. Me një pushkë në thes eci drejt Malit me Borë. Pasdite vonë arriti dhe ashtu si e kishte paramenduar zuri pusinë. «Për të luftuar, tha me vete, do të luftoj, por edhe mall për treg do të mbledh, mbasi do të ishte turp të humbesh kot të mirën që të sjell vera nga dëra.»

Nga shumë shtigje zbritën malësorët e armatosur. Gushteri nuk doli nga vendi i maskuar. Aty nga mesi i natës repartet e para të ushtrisë osmane u pri-

tën me zjarr të rrufeshëm në Grykë. Lufta vazhdoi gjer të nesërmen në mëngjes. Ushtria turke po zbrazej në panik duke lënë qindra të vrarë. Gushteri dilte nga guva, mblihte pushkët e të vrarëve, i futte në strehim dhe rikthehej. Mirëpo në këtë kohë duket se turqve u erdhën përforcime dhe u rindez beteja kur po mbaronte. Bajraktari i malësisë, një burrë tridhjetë vjeç, për t'u dhënë zemër malësorëve, si ndonjë petrit me flamur në duar zbriti kërshit duke bërëtitur si i çartur. Gushterit, vendi ku kishte zënë pusinë, i dha mundësinë të shikonte mirë edhe shpatet e maleve tutje. Ai pa se qindra malësorë të krahinave të tjera po e mbyllnin grykën dhe po e futnin armikun në një unazë të zjarrrë.

Në këtë kohë, bajraktari i katundit të tij u gjet nën breshëritë e armikut që po përzihej në një vorbullë vdekjeprurëse të pashpresë shpëtimi. Mendja Gushterit si asnjëherë tjetër filloi t'i rrihte edhe për lavdi. Ai e dinte zakonin e malësisë se, kur bie bajraktari, i pari luftëtar që kap flamurin dhe u prin luftëtarëve, emërohet bajraktar. Nga një titull i tillë ai mendoi se sa fitime mund të kishte dhe në çast vendosi. Nga flamuri i shtrirë përdhe me luftëtarin e vrarë nuk e ndanin më shumë se njëqind hapa. Gushteri e mori me mend se fitorja u buzëqeshte kryengritësve malësorë. Zbriti si ndonjë zog grabitqar, e mbërtheu flamurin me të dyja duart, u kthye nga malësorët dhe bërtiti: «Kush është trim, mbas meje! O burra t'i biem hasmit!» Malësorët kryengritës të egërsuar kundër shtypjes së egër anadollake, të pezmatuar nga vrasja e prijësit të katundit të tyre dhe trimave të tjerë, u vërsulën fytyfyt mbi armikun. S'kaloi shumë dhe kryengritësit i thyen plotësisht turqit. Mahmut Gushteri u shpall baj-

raktar. Titulli e bëri Gushterin që aty për aty t'i lin-
te armët të fshehura, erdhi dhe i mori pas katër
netësh.

Mahmut Bajraktarit atë vit i lindi gruaja djalë,
Durgutin. Mahmuti edhe si bajraktar nuk e harroi
tregëtimin e armëve. Pas dhjetë vjetësh përmendej
në gjithë malësinë për pasurinë e madhe që kishte
grumbulluar.


Pas vdekjes së Mahmutit, bajraktarllëku i mbe-
ti të birit, se kohët kishin ndryshuar, titulli tani tra-
shëgohej dhe nuk fitohej në luftë si më parë. Dur-
gutit i digjej shpirti për toka, i ati i kishte lënë shu-
më bagëti e verdhushka, por tokë as vend sa për një
varr. Durguti dijenitë që kishte trashëguar nga i ati
i zgjeroi. Ai vërtet nuk ushtroi hajdutërinë, po më-
soi mjete të tjera për t'u pasuruar. Nëse i ati tij tho-
shte se njeriu lypset të zgjedhë o trimërinë, o pasu-
rinë, se dy shalqi nën një sjetull nuk mbahen, i biri
mendonte ndryshe: «Ai që ka pasurinë, ka nderin
edhe trimërinë; kanë ndryshuar kohërat, nëse nuk
mundesh t'i mbash dy shalqi nën një sjetull, i fut
në hejbe dhe i ve në krah» — thoshte ai dhe filloi të
vepronte me mjeshtëri e dinakëri. I ati u shiste pu-
shkë katundarëve për t'u vrarë vëllai me vllain, Dur-
guti zgjodhi ngasjen për grindje. Qysh moti ja kishte
vënë syrin arës në luginë të një bashkëfshatari të
vet. Pasi s'ja doli duke i dhënë pare me fajde për ta
sjellë gjer në atë gjendje sa t'ja merrte tokën, shpi-
ku mjetin tjetër. I dha të holla një kriminelit dhe vrau
një mashkull të pronarit të arës në luginë, nga ana
tjetër, në mënyrë shumë të stërholluar bëri që të
përshtëpëritej në fshat se gjoja gjaksi ishte një fqiu i
Durgutit, Hyseni (edhe ai kishte dy ara nën kroin e
fshatit). Si shkak për vrasje gjoja kishte genë var-

disja e të vrrarit ndaj vajzës së Hysenit, fqinjit të bajraktarëve. Pas një muaji pronari i arës te lugina vrau Hysenin. Pas ca kohe vëllezërit e Hysenit vranë pronarin e arës në luginë bashkë me të birin. Vrasjet vazhduan. Të dy familjet ranë ekonomikisht e mbasi gjaqet i detyronin të mbylleshin, si përfundim as nuk mund të siguronin bukën e gojës. Për të mos vdekur urie, i pari që u drejtua për borxh te Durguti, qe fqinji. Nuk vonoi që edhe familja tjetër të merrte prej bajraktarit aq borxh, sa s'ua lante as shtëpia bashkë me arën në luginë. Durguti ishte dorëlëshuar, ai u jepte sa të donin, duke pasur si peng dy arat nën kroit e fshatit dhe arën në luginë.

Në këtë mënyrë Durgut Bajraktari nga viti në vit shtonte pronat. Ai kaloi kufitë e fshatit të tij, shtiu në dorë edhe shumë prona, bile krijoi çifliqe në dy katunde.

«Bajraktarllëku, thoshte Durguti, dikur ka shërbyer që t'u prijë njerëzve në luftë, të kishte itibar e nder ndër miq e shokë, të ta lëshonin ballin e oxhakut, kurse sot më duhet të më shkojë fjala, të ma kenë frikën të tjerët, të bëj shumë pasuri, toka, toka sa të më dojë zemra. Atij që ka pasuri, shumë prona, ja kanë nevojën dhe frikën».

Durguti nuk i jepte çdo njeriu drithë ose pame fajde. Kur ndonjë i varfër trokiste në portën e tij, ai e kthente me duar bosh duke i thënë që të dukej pas një jave. Aq kohe i duhej sa të bënte llogari. Nëse nevojitari kishte diçka të çmueshme si peng për borxhin e marrë, atëhere bëhej dorëlëshuar, përndryshe nga dora e tij nuk dilte asnjë okë misër. Meqë kishte katër djem, Zenunin, Kurteshin, Kajmakun dhe Kalemin, i lypsej të mendonte edhe për nuset e të-bijve. Ai nuk mendonte si njerëzit e së-



~~13305~~

1686

rës së tij, që djemve t'u gjente nuse prej dere të madhe e oxhaku, se ashtu martesat do t'i kushtonin shumë; arësyeja tjetër ishte se vajzat prej dere e oxhaku ishin të përkëdhelura dhe kishte kush i mbronte, kurse varfanjakët i blije me një copë bukë dhe i përdorje ashtu qysh të ta donte qejfi. Cen Rrushi pat qenë bashkëfshatar i Durgutit. Ai qe vëllai më i vogël dhe patën pasur ca bagëti e tokë sa për misër, thekër e për pak patate, por i kurdisi kurthin Durgutit si të tjerëve, saqë jo vetëm tokën e bagëtinë i la në Ahishtë, por edhe tre vëllezërit më të mëdhenj dhe iku çifçi te beu. Skamja e dërgoi Cenin edhe një herë në derën e Durgutit. Bajraktari për një mushkë misër bleu vajzën e Cenit për Zenunin. Edhe për djemtë e tjerë veproi kështu.

Durgut Bajraktari po plakej. Meqë Zenuni i dukej disi dorëlëshuar, vendosi ta dërgonte në shkollë. Dy djemtë e mesit i çoi nëpër çifliqe, kurse të voglin, Kalemin, meqë e kishte me gruan e re e të bukur, e mbajti pranë vetes.

Zenuni ja pat sjellë në majë të hundës. Në të tëra i ngjante t'atit, por ishte i dhënë shumë pas femrash. Mësimet i hynin në njërin vesh dhe i dilnin prej tjetrit. Bajraktarit plak i pat ardhur plasje se për çdo fund viti i lipsej t'i dërgonte nga një qengj drejtorit të shkollës, për t'i kaluar të birin.

Zenuni bëri si bëri dhe e mbaroi shkollën ashtu si e mbaronin zakonisht bijtë e bejlerëve. Kur u kthye në Ahishtë, i tha të atit se desh të merrej me tregëtinë e lëkurave dhe të duhanit. Durguti i pëlqeu këto plane, por, që të lidhte të birin pas shtëpie dhe që ta shmangte nga harxhimet në harbime, vendosi ta martonte. Dërgoi njerëz te Cen Rrushi që ta pregatiste vajzën për martesë. Zenuni, për të cilin

martesa e menjëhershme që e papritur, nuk u dëshpërua, sepse vajzës së Cenit, Havës, i kishte dalë nami për bukuri në gjithë zonën fushore. Mirëpo ajo u arratis me një tjetër dhe në këmbë të saj në shtëpinë e Bajraktarëve sollën të motrën, Hiqen. Kjo gjë e handakosi Zenunin, ai nuk do t'ja falte kurrë Havës, nuk do të prante për asnjë çast së vjelluri vrer kundër së arratisurës. Zenunin, edhe pse e dëshpëroi pa masë kjo martesë e papëlqyer, u ngushëllua sepse së shpejti do të nisej jashtë shtetit. Me një trastë pare do të grumbullonte lëkura e duhan. Jashtë shtetit, siç i kishin thënë njerëzit e sërës së tij, njeriu mund të dëfrente sa të donte, vetëm para të kishte.

E filloi punën dhe i vajti mbarë tregëtia. I ati, Durguti, sapo mori një tufë kartmonedhash, harroi çapkenlleqet e të birit dhe filloi të betohej në kokën e tij. Zenuni mblidhte lëkura nëpër malësi, siç i thonë fjalës për një copë bukë, dhe i shiste në Itali me çmime të majme. Në Bari të Italisë hapi një dyqan, pajtoi agjentë dhe bëri kontratë me disa firma.

Herë pas here vinte në malësi sa për të rrahur dhe për ta lënë me barrë të shoqen, e cila çdo kryeviti ja dhuronte nga një djalë. I ati, megjithëse plaqej, nuk ngopej as prante së bleri tokë.

Kohë të turbullta vërshonin mbi Shqipërinë.

Një ditë dy misionarë të huaj gjetën dyqanin e Zenunit. Ata i folën për një të ardhme të afërt dhe të largët. Zenuni, edhe pse ishte i madh në dallavere, në fillim nuk i kuptoi.

Me rrukullisjen e situatave, ai u qartësua përsa i kishin folur ata misionarë, të cilët sa shkante dhe i shpeshonin vizitat. Ata e kishin studjuar mirë ka-

rakterin e Zenunit. Njeri që ka zë në malësi, njeri fjalëpak, njeri që shiste të ëmën dhe të atin për një grusht parash, me një fjalë dry pa çelës. I tillë njeri u duhej atyre, i tillë ishte edhe Zenuni.

* * *

Nëpër rrugët gërmadhë të Shqipërisë, bashkë me gjethet e pemëve në vjeshtë filluan të qarkullonin edhe ca fletushka dhe trakte. Flitej se njerëz të kuq dilnin natën, bile edhe ditën në diell dhe vrisnin oficerë këmishëzinj dhe agjentë. Këta të kuqtë qenkëshin shkatërrues të pronës private, qenkëshin për të varfërit, për ata që lumturinë e shikojnë përmes pikës së djersës. Me të kuqtë qenkëshin bashkuar të gjithë punëtorët dhe fshatarët. Këto lajme u ngjitën edhe monopateve të malësisë, u futën në kasolle e në kulla, kuturisën edhe në veshët e Durgut Bajraktarit. Në atë kohë bajraktari plak kishte përmbysur laçka e plaçka duke kërkuar testamentin që e kishte shkruar kohë më parë. E kishte humbur. Ai nuk e dinte se ja kishin vjedhur të dy djemtë, Kajmaku e Kurteshi që i kishte degdisur në çifliqe.

Brenda javës plaku vdiq nga dambllaja.

Zenun Bajraktarit të nesërmen i shkuan tri telegrame brenda nëntë orësh:

«Babai është keq, i ka rënë dambllaja. Eja se kërkon të të shohë!»

Telegrami i dytë:

«Babai, Durgut Bajraktari, vdiq, nisu urgjent!»

Telegrami i tretë:

«Ka plasur grindja. Kajmaku dhe Kurteshi kër-

kojnë të na marrin të gjithë pasurinë! Nisu urgjent!
Kalemi.»

Megjithëse telegramet ishin nisur dhe kishin mbërritur në kohë të ndryshme, Zenunit i ranë në dorë të tre përnjëherë. Telegramet kishin vajtur në dyqan. Zenuni gjendej në shtëpinë publike.

Meqë njëri nga misionarët e dinte se ku gjendej, shkoi, e nxori që andej dhe i tha:

Qysh tani lipset të niseni për Shqipëri!

Zenuni, duke u shtritur, i foli: — Ju më keni thënë se loja do të fillojë më vonë!..

— E ke babain sëmurë — i tha misionari.

— Kështu e kanë pleqtë... — ju përgjegj Zenuni.

— Babai të ka vdekur — i tha misionari.

— E ka pasur vaktin... — foli pa u shqetësuar Zenuni.

— Kajmaku dhe Kurteshi duan të ta grabitin gjithë trashëgimin, do të të lënë me gisht në gojë... — tha misionari.

— Jo, jo! Tani do të nisem, kanë për të më parë se kush jam!..

Misionari qeshi dhe foli: — Më datë 27 të çdo muaji tek Ura e Matit do të takosh një person. Nga ai do t'i marrësh të gjitha. Do të të ndihmojmë dhe për përvetësimin e trashëgimit... —

— Falemnderit?

— Gjithmonë do të na kesh pranë... —

— Falemnderit.

— Asnjë përzierje në politikë... —

— Si urdhëron.

— Këtë shishe për vëllezërit e pabindur dhe kush ta ka borxh një jetë.... —

- Si përdoret?
- Në pije ose kafe....
- Mirë u pafshim!

* * *

Kur Zenuni u ngjit në Ahishtë, dëgjoi nga larg klithmat e grave. Ai shpejtoi hapin, harroi se i kishte vdekur i ati, pandehi se mos vëllezërit ishin përgjakur për shkak të trashëgimit.

Si hyri në kullë, u përshëndet me burrat që kishin ardhur për ngushëllime dhe, meqë nuk i durohej, thirri të tre vëllezërit në dhomën tjetër, kurse kafexhiun e porositi të bënte katër kafe.

— Si e keni punën? — i pyeti ai vëllezërit.
— E varrosët babain?

— Po, — ju përgjegj Kalemi — po Kajmaku dhe Kurteshi thonë se unë dhe ti nuk kemi pjesë në tokat, trashëgimin që na ka lënë babai....

— Si kështu — foli Zenuni gjoja duke qeshur.

— Po, — tha Kajmaku — neve babai na e la testamentin.

— Jo, — u përgjegj Kalemi — babai ma tha me gojën e vet se testamentin ja kishin vjedhur. Këta ja kanë vjedhur dhe kanë shkruar vetëm emrat e tyre....

— Ja testamenti — tha Kurteshi dhe e nxori dokumentin duke e mbajtur me të dyja duart.

— Kush i ka shkruar emrat? — pyeti qetë-qetë Zenuni.

— Babai, — u përgjegj Kajmaku — te noteri.

— Betoheni?

— Si jo — u përgjegjën të dy vëllezërit njëzëri.

— Shumë mirë — tha Zenuni gjakftohtë, e doli jashtë e ju afrua kafexhiut.

Katër kafe ishin radhitur në tepsi, Zenuni pasi i rregulloi filxhanët, u kthye te vëllezërit. Pas tij u hap dera, një djalosh i solli kafetë.

— Le t'i pimë këto kafe për shpirtin e babait!
— tha Zenuni.

— Unë nuk ja lë askujt pasurinë që më takon!
— foli Kalemi duke mbajtur filxhanin në dorë.

Zenuni e qëlloi në dorë Kalemin, kafeja u derdh, filxhani ra mbi rrasën e gurit pranë oxhakut dhe u bë copë-copë. Zenuni i tha:

— Ashtu e ka parë të udhës babai, amaneti i tij lë të jetë ligj për ne! — Dy vëllezërit e tjetër filluan të pinin kafetë. Kalemi po nxehej.

— Kalem, do heshtësh, apo... — e kërcënoi Zenuni dhe i zemëruar e hodhi filxhanin bashkë me kafe në oxhak. Pastaj ju drejtua Kajmakut dhe Kurteshit:

— Unë ju besoj, po, që të bindet Kalemi, të mos thonë bota se vëllait më të vogël ja grabitën pasurinë dhe e lanë me gisht në gojë, do të betoheni përpara burrave në odën tjetër.

Dy vëllezërit e mesmë u vështruan sy më sy. Pranuan.

Të katër dolën në odën e burrave. Zenuni foli:

— Burra, Kajmaku dhe Kurteshi përpara jush do të betohen se nuk ja kanë vjedhur babait testamentin, se nuk kanë bërë asnjë falsifikim. Betohuni, vëllezër!

— Si të betohemi? — pyeti Kajmaku.

— Do të tloni: «Mos e gëzofshim jetën asnjë orë, nëse nuk na e ka lënë babai testamentin, nëse

kemi bërë ndonjë falsifikim, ose nëse gënjejme!»

Të dy vëllezërit u betuan me gjysmë zëri.

Zenuni si pa të keq filloi bisedën me burrat. Ai pyeti, siç e kishte zakon, për fëmijët, për bagëtinë...

Nuk zgjati asnjë orë. Kajmaku dhe Kurteshi zgurdulluan sytë sa të çonin lemerinë dhe u shtrinë të vdekur përdhe. Disa supersticiozë, sa panë këtë tragjedi, të frikësuar ja mbathën nga oda. Të tjerë mbetën të nemitur. Hoxha i katundit foli:

— Burra, dijeni se Zenun Bajraktari është shenjt. Të dy vëllezërve betimi i rremë ua hëngri kokën.

Atë ditë afër varrit të Durgutit plak i futën edhe dy të bijtë. Varrezave të Bajraktarëve për një javë ju shtuan tri varre burrash.

Zenuni, meqë i ra shtëpia mbi krye, hoqi dorë nga tregëtia.

Lufta e madhe kundër zaptuesit plasi në të katër anët e vendit. Të parët që trokitën në portën e Zenun Bajraktarit ishin ata të Legalitetit. Zenuni u shtroi pije e sofër të majme, u dha shpresa dhe i mburri. U tha se do t'i ndihmonte me mjete të tjera por jo me pushkë, pasi atij i lypsej të qeveriste pronat dhe çifliqet. Pas ca ditësh në kullën e Bajraktarit erdhën njëri pas tjetrit, përfaqësuesit e Ballit kombëtar, social-demokratët, sojsorollopë, u ngritën dolli, u shpua tavani i kullës nga plumba të lloj-lloj armëve e kalibrave. Për të gjithë përgjegjja e bajraktarit qe e njëjtë, vetëm se me fjalë të ndryshme. Zenuni kishte udhëzuesit e vet, planet e veta. Ai mendonte: «Le të fitojë cilido, vetëm komunistët jo. Kushdo që të fitojë, përveç të kuqve, bajraktari mbetet bajraktar, i pasuri i pasur, mua do të më ruhet kreu i vendit. Mishi të piqet; helli të mos digjet.»

Kur sëpatës musoliniane ja zuri vendin kryqi i thyer, Zenuni mbajti tri ditë zi, helbete italishten e dinte, gjermanishtes s'ja thoshte. Por zija zgjati aq sa zgjatin tri ditë dimri. Këmisha mbeti e zezë se e zezë.

Asnjanësisë po i tundej dhe nën këmbë. Vrapoi në vendin rezervë të takimit me misionarin dhe i shprehu mendimin se nuk kishte hije të qëndronte i paanshëm. Atë natë misionari i foli pak më hapur se netët e tjera. Zenuni e mori me mend se atij i lyptej gjithmonë të ishte i treti që duhet të fitojë midis dy vetash që grinden dhe telat e politikës së tij i akordoi si më parë.

«Mishi të piqet, helli të mos digjet. . .» tha ai me vete dhe u kthye në kullën e tij.

Kishte kohë që qarkullonin fjalë se Dan Rrushi, kunati i tij, kishte dalë në mal me partizanët dhe luftonte si i çartur kundër gjermanëve dhe soj e sorollopit. Zenuni qysh kur mori lajmin e parë, e sktroi në dru Higjen. Pastaj në ndeje burrash tha me plot gojën se ai, megjithëse mbante për grua motrën e Danit, lidhjet e miqësisë i kishte shkëputur kohë më parë.

Mirëpo hitlerianët që s'u besonin jo fjalëve, por as rrobave të veta, një natë me dy-tri motoçikleta u gjetën në kullën e Bajraktarëve dhe e morën Zenun Bajraktarin. Se ku e mbajtën tri net, e di vetëm Zenuni. Por kjo ngjarje u bë shkak që më vonë bajraktari ta quante veten hero e shkuar heroit. Ndoshta do ta kishin degdisur në ndonjë kamp siç syrgjynosën shumë fshatarë që vinin në pazar për të shitur dru, por dora e fortë e misionarit e nxori që andej me ta marrë vesh, megjithëse kurrë nuk është përmendur emri i shpëtimtarit nga goja e bajraktarit.

Pesë ditë pas kthimit të Zenunit në kullë, erdhi

misionari si mysafir, u shtruan të gjitha të mirat, të denja për sofrën e bajraktarit tregëtar e çifligar. Gjatë pijes Zenuni disa herë brohoriti për angloamerikanët, meqë misionari nuk piu shumë, filloi biseda sa zyrtare aq edhe intime. Pas çdo fraze Zenuni thoshte: «Mishi të piqet, helli të mos digjet». Misionarit i pëlqeu pa masë kjo sentencë dhe tha se në përmbajtjen e saj gjendej thelbi i politikës së dy fuqive të mëdha në Shqipëri e në Ballkan. Ai shtoi: «Lëvozhgat e arrës hidhen në zjarr, kurse thelbat i ha i zoti i punës dhe ngrohet». Zenuni me mendjen e tij bëri komentin: «Lëvozhgat e arrës janë gjithë ata budallenj që hidhen në luftë kundër gjermanëve, që pregatitin thelbat e qëruar, lirinë për ne. Jepi misionar, o të keqen, ma ke atë rradake plot me mend». Misionari në fund tha se pas një jave bashkë me disa zotërinj duhej të strehoheshin aty afër, se bazat e tjera nuk ishin të sigurta, sepse tanimë ndodheshin në zona ku kishin vendosur pushtetin e vet këshillat nacionalçlirimtare. Zenunit ju kujtua e veja e të vllait, Kajmakut, e cila banonte në një kullë të vetmuar bashkërisht me dy djemtë e vet. Aty për aty mendoj që ta vizitonte kumatën bukuroshe. Të nesërmen dërgoi shërbëtorin te vejusha, i cili mori të dy djemtë kinse i kërkonte xhaxhai i përmalluar.

Kur djemtë me shërbëtorin hynë në kullën e bajraktarit, Zenuni u nis për udhë. Mbërriti atje me të perënduar dielli. E kunata e priti ashtu qysh pritej vëllai i madh i burrit, edhe pse nuk i pëlqeu shkëlqimi i syve të Zenunit, përzier me epush e keqdashje, ajo bëri sikur nuk kuptonte asgjë, siç bëjnë zakonisht gratë e mira, që nuk duan t'i ofendojnë burrat e bezdisshëm. Zenuni kishte ardhur për dy çështje me rëndësi, të rregullonte strehimin e padronëve

dhe... Një rrugë e dy punë, një të shtënë, dy zogj... Ai hezitoi një herë se cilin muhabet të fillonte të parin. Trokëllimat e zemrës mundën forcën e arësyes, prandaj e filloi punën pa fjalë, po me dorë duke e përkëdhelur të kunatën nën gushë. Ajo bërtiti e trembur dhe desh të ikte, po, kur bëri të dilte nga porta, u gjet në duart e fuqishme të të kunatit, i cili e shtroi përdhe. Vejusha, siç e kishte shtizën ndër duar, ja nguli mu në sy.

Të nesërmen Zenun Bajraktari u gjet në spital. Plaga ishte infektuar; syri duhej nxjerrë dhe ja nxorën.

Hakmarrja e Zenunit nuk vonoi. Pas dy muajsh u hap fjala se vejusha e Kajmakut ishte hedhur nga shkëmbi. Arësyeja e vetvrasjes nuk dihej...

Kulla e vetmuar e së vesë së Kajmakut u kthye në bazë për misionarët; bile edhe pak ditë pas Çlirimit të vendit.

Zenuni aq tepër ishte përpirë nga premtimet dhe moralizimet e misionarëve, saqë çlirimi i vendit e gjeti si të shushatur. Ai parullës së preferuar «Mishi të piqet dhe helli të mos digjet» i shtoi edhe parullën tjetër: «Sipas motit, gëzofin...» Mbasi u këshillua mirë e mirë me misionarët, vendosi të bënte çmos që t'i hýnte në zemër kunatit të vet, Dan Rrushit, në anën tjetër të shiste çfarë mund të shiste sa më parë, që të mos ja merrnin dhe të grumbullonte paranë e bardhë për ditë të zezë. Misionarët si fjalë të fundit i thanë Zenunit: «Të tjerë mbollën, ne do të korrin. Kini durim, se koha nuk mund të caktohet, por, që nuk e kanë të gjatë rreckamanët, kjo është e sigurt. Tani mbetet për të marrë kalanë nga brenda, për ta bërë këtë, lypset pak trimëri, e njëqind dinakëri».

Zenuni filoi t'u përshtatej kushteve. Ai nëpërsheshe e ndeje fliste vetëm për kunatin e tij, Dan Rrushin, të cilin e ngrinte në qiell, tri ditët e burgimit të tij u kthyen në legjendë. Ai thoshte se kishte vuajtur aq tepër, saqë nuk do t'ja kalonte asaj ngjarjeje as dita e varrit. Sajonte plot lajle lule të tjera, saqë edhe vetë filloi t'u besonte gënjeshtreve të veta.

Familjes së Bajraktarëve ua lypte nevoja që për djemtë e tyre të zinin nuse nga familje komunistësh, njerzish që kishin kontribuar me tërë shpirt në Luftën nacionalçlirimtare, sepse mendoheshin të shpëtonin lëkurën, dhe të mbanin kokën lart në mënyra të tjera. Bajraktari vetë e shkurttoi emrin nga Zenun në Zun, mbiemrin nga Bajraktari në bajraktarëve. Kur ndokush thoshte se ata nuk kishin kontribuar në luftën për çlirimin e atdheut, ata përgjigjeshin: «Vërtet ashtu është, po na pat marrë më qafë bajraktarllëku, se na e lanë trashëgim. Pastaj ç'ka hequr Zuni i shkretë! Gjatë reformës kishin shpresuar, por, kur panë se ua morën ç'kishin, kundërshtuan meqë nuk ua varën, thonjtë e revoltës i fshehën, vazhduan të maskoheshin nën hijen e mikut të tyre, Dan Rrushit, edhe pse ai vetë ja kishte dorëzuar grumbullimit treqind kokë dele që ja kishin dërguar për t'i fshehur në shtëpinë e tij. Zenuni ishte mjeshër për t'u maskuar.

Vitet e hovshme po ecnin. Bajraktarët filluan të kërkonin mjete të tjera. Vitet e fundit kishin rënë tersllëqe mbi kokën e Zunit të Bajraktarëve si çurrielojnë shirat e vjeshtës.

Djali i madh, një natë, pa pritur e pa kujtuar, i tha Zunit: «Babë, unë dua të ndahem!

Zuni kishte zgurdulluar syrin e shëndoshë dhe

s'u kishte besuar veshëve për guximin e të birit, i cili as që ja vari, po vazhdoi:

— Ti, babë, na e ke bërë jetën skëterrë. U rrita kaq dhe asnjëherë s'kam guxuar të hap gojën, sepse me ne je sjellur dhe sillesh si me shërbëtorët e tu dikur. Të kemi baba, por je një pikë helm, që të kishe mundësi, do të helmoje dete. Por pika është pikë dhe deti mbetet det. . . Nuk mund ta duroj më këtë jetë prej skllavi brenda kësaj kulle me mure prej guri. . . . Ti di vetëm të gënjesh e të shtiresh.

Zuni nuk u përmbajt. Ja pat të birit me hurin e ndezur që rrëmbeu nga oxhaku. E goditi aq keq, sa e la pa ndjenja. Djali, kur u ngrit, pa se aty ishin edhe dy vëllezërit e tij.

— Dëgjoni, vëllezër, u tha. Ne të vërber nuk jemi, ne shikojmë mirë se si jetojnë moshatarët tanë dhe si jetojmë ne. Ne ngjajmë me kufoma që lëvizin. Ç'jemi ne me sjelljet dhe veprimet tona të shtyrë nga Zuni i Bajraktarëve? Asgjë tjetër përveç se krimba të qelbur. Bukëshkalë jemi ne, e Zuni i Bajraktarëve pret më kotë ndonjë mrekulli nga qielli. . . Vdiqën, u vjen era kërmë Zunëvet të Bajraktarëve, ëndrrave të mykura. . .

Zuni doli jashtë me vërtik, sa hap e mbyll sytë, u kthye me sëpatë në dorë:

— Kjo dorë — tha ai — u ka hequr kokën plan-gëprishësve më të fëlliqur se ti!. . Mbamani! — ju drejtua dy djemve të tjerë. Për çudinë e tij djemtë ju hodhën mbi kurriz:

— Qenka çmendur — thanë ata dhe e lidhën të atin.

Qysh të nesërmen të tre djemtë e Zunit me nusët dhe fëmijët e tyre bartën plaçkat dhe shkuan në fermë.

Hiqja dha kujën.

Ikja e djemve të Zunit habiti gjithë katundin. Dikush tha: «Është ujk i vjetër Zuni, nga i bie çari, i lëviz kandari...» Një tjetër tha: «Jo, ai këndes pa pupla sillej me të bijtë tamam si bajraktar. Nuk kanë mundur ta duronin, prandaj e braktisën.»

* * *

Një natë Zuni i kishte thënë Kalemmit:

— Vëlla, djali po të rritet...

— Është rritur e po plaket, lypset ta martojmë, Zun...

— Si të duket bija e tim kunati?

— E cilit kunat?

— E Dan Rrushit.

— S'na e jep, o Zun, ai është i kuq, është komunist...

— Ti, Kalem, je budalla! Edhe ne po shtiremi si ata...

— Ne shtiremi, po s'na e ka kush besën.

— Kurrë mos mendo prapsht!

— S'na e jep, o Zun.

— Do t'ja bëjmë siç bëmë për martesën e atyre lanetërve të mi, që më braktisën...

— Aq më keq, nusja të ma kthejë djalin për vete, një ditë të mbetem pa djalë siç mbete ti...

— Pesho fjalët e mos ngacmo plagët, Kalem!

— Më fal, Zun.

— Dëgjo, Kalem, një zot shtëpie ka këtu!

— Folë, Zun se fjala nuk të bëhet dy.

— Dëgjo, pra, Hiqja do të shtiret si e sëmurë. Unë do të shkoj te Dan Rrushit dhe do të kërkoj që

ta lejojë të bijën që të vijë te ne për t'i shërbyer hallës së vet të sëmurë.

— Pastaj?

— Pastaj, pyet ky! Djali ynë do t'i vardiset. . . .

— Femër e ke atë kaploqe, o Zun!

Zunit ju përkëdhel sedra, fërkoj syrin e verbër dhe vazhdoi:

— Koha të dikton armën, lufta të mëson si ta përdorësh atë. Partizanët ua grabitën armët gjermanëve dhe i luftonin me ato, përse të mos përfitojmë nga kjo përvojë? . .

— S'të kuptoj. . . .

— Shumë bukur, — shpjegoi Zuni — e hoqën shkesllëkun, edhe ne fillojmë me dashuri. Lamë i vardiset Dritës së Danit, Hiqja ja ushqen nepsin asaj. Në s'do miqësinë tonë Dan Rrushit, fakti i kryem s'të le të lëvizësh bishtin. Por Lamit lypset t'ja bëj një kurs.

— S'ta bëj fjalën dysh, o Zun.

Zuni i Bajraktarëve filloi nga puna.

Kur Zuni ndeshi në kokëfortësinë e Hiqes, i hyri si gjithnjë në dru. Por trupi i Hiqes ishte regjur. Ajo nguli këmbë në të vetën si mushka. Zuni pa ç'pa ktheu anën tjetër të medaljes. Ai i njihte mirë plagët e së shoqes, prandaj i futi duart gjer në bërryle në to:

— Hiqe budallaqe, — i tha ai — në rrembat e tu nuk rridhka më gjak, po ujë. Sa herë ta ka hapur derën yt vëlla?! Nuk qe yt vëlla që të përzuri, kur shkove t'i lutesh të mos i dorëzonte të gjitha delet që i kishim fshehur tek ai?! Nuk qe Dan Rrushit ai që erdhi bashkë me ata të reformës dhe na e mori të gjithë tokën dhe të lanë ty e mua me gisht në gojë?! Përse na braktisën djemtë dhe na lanë si dy

qyqarë tani në pleqëri? Sepse ai vëllau yt komunist
vulli vrer kundër nesh. Hava, tani, për t'u hakmarrë
se nuk i flet, e ndërseu vëllain kundër teje, i ndër-
seu djemtë tanë kundër nesh. . . . Ti, Hiqe, më dhim-
bsesh, ke mbetur njeri pa njeri. Miqësia e re me tët
vëlla na afron. Për hir të vajzës së vet vëllai do të ta
hapë derën edhe ty. Bëje këtë për inat të Havës dhe
të Davës, ato ta rrëmbyen dashurinë e të vëllait, ua
kthe në të njëjtën mënyrë. Ti duhet ta dish se këtë
e bëj vetëm për ty, se nuk më ka marrë malli ta bëj
Dan Rrushin edhe një herë mik. Nuk i harroj unë
taksiratet që i ka sjellë kullës sonë ai me shokët e
vet. Duhet ta dish pra se këtë e bëj vetëm për ty,
i vetmi njeri në këtë botë, njeriu më i afërt më ke
mbetur ti. . . — Zuni kujtoi kohët e fundit që i ki-
shin ardhur shumë ters dhe shtrydhi një pikë lot
nga syri i vetëm.

Hiqes, kur ja përmendi motrat, i vloi përbrenda
inati e cmira e vjetër që e kishte mbajtur të fshehur
në thellësitë më të errëta të zëmrës. Ajo, në mos si
Zuni, në mënyrën e vetë e gjeti të udhës se asaj pu-
ne i duhej hyrë me gjithë shpirt.

«Hava qe ajo që më shkaktoi fatkeqësinë e parë,
u arratis me bandillin, ma turpëroi familjen, mendoj
Hiqja, mua m'u desh të martohem me ish të fejuarin
e saj. Nga shkaku i Havës mbetëm jetime pa baba.
Si Hava ashtu edhe Dava pushpuritnin si pulat në
pleh, kurdisnin fjalë të këqija kundër meje, se unë
isha vajzë zamani. Sa herë më patën thënë haptas se
e kisha më pak të shëmtuar fytyrën se sa shpirtin.
Ato tani hyjnë e dalin te vëllai, kurse unë, që i qën-
drova gjer në fund besnik kanunit, u mbylla për së
gjalli. Më është mohuar dera e babait. . . . Tani do ta
fut në kurth Dritën. I rrëmben deles qengjin, ajo të

ndjek pas. Kështu ka për të ngjarë edhe me vëllain tim. Le të pëlcastin Hava dhe Dava. O zot i madh, tani po më jep dorë që të derdh vrerin e kaq kohe! Shpërthe mullan!».

— Hë, moj, si thua? — e nguci përsëri Zuni që po e hiqte llullën pranë saj.

— A do t'ja arrij, o njeri? — ja ktheu me pyetje Hiqja.

— Do t'ja arrish, bile fare lehtë. Drita përpara një jave mbaroi uniken. Unë do të shkoj sot dhe do të ta sjell këtu. Lypset forca e ustallëkut tënd. Dëgjo, së pari t'ja lavdërosh Lamin. Po ki kujdes mos vill helm kundër këtyre që na rrëmbyen tokë e bagëti siç e ke zakon, se të iku zogu. Prit sa ta futim në kafaz, pastaj do të këndojë sipas avazit tonë. Fjala nxjerr fjalën; këtë s'e kam menduar më parë, po vajza e Danit si nuse te ne ka për të na ngritur edhe vlerën, se fort po na marrin nëpër këmbë... Vetëm të kam rixha mos e lërë gjuhën më të të lëvizë sipas zakonit. I thuaj asaj bijës së Danit se Lami lë kokën për këtë qeveri, i thuaj gjoja si me inat se Lami na kritikon ne, sepse ishim si të parë të krahinës e pak si të pasur. Të tjerat ja thotë vetë Lami asaj...

Zuni i foli edhe shumë të tjera, pastaj shkoi te Dan Rrushi. Në mbrëmje u kthye bashkë me Dritën, e cila «hallën shumë të përvuajtur» e gjeti shtruar në lëkurë oghiçi gati «duke dhënë shpirt.» Dritës vërtet i erdhi keq, ajo për dhjetë ditë rresht i qëndroi hallës te koka. Ja njomte ballin me lecka të lagura. Kurse Hiqja, duke rënkuar, fliste e fliste.

Drita Rrushi ishte rritur në një ambient ku intrigat dhe dallaverat nuk njiheshin. Ajo u besonte fjalëve, por kurrë s'e kishte lodhur mendjen se çfarë

fshihej prapa atyre që thuheshin. Ajo ende nuk e dinte se shpesh e thëna nga e bëra ishin shumë larg. Ishte rritur si fëmijë e vetme plot shëndet dhe ishte zhvilluar si ndonjë llstar i hazdisur, me atë trupin tfillak, e të gjatë, belhollë, me gjoksin të bëshëm, hundën të drejtë e sytë të shkruar. Këto e kishin bërë atë të dallohej si një vajzë e bukur.

Lami tridhjetëvjeçar, pre e intrigave të xhaxhait dhe të të atit, i ndërsyer kundër çdo gjëje të re, punën e rregullimit me Dritën e mori si një aksion me shumë rëndësi. Ai ua kalonte në dinakëri, Kalemmit po se po, por edhe xhaxhait që kishte kryer shkollë. Lami i Bajraktarëve i ngjante një këlyshi që, sapo ka filluar të lehë, e kanë shembur në dru. Ai kishte mësuar të kafshonte tinëz. Me një fjalë, nëse Zuni hidhte gurin dhe fshihte dorën, Lami hidhte gurin, fshihte dorën dhe kokën bashkë.

Lami në fillim vetëm i buzëqeshte i mpakur Dritës, i fliste për hovin revolucionar, për aksionet e rinisë. Dalëngadalë ai mësoi se çfarë i pëlqente dhe çfarë urrente Drita.

Vajza e padjallëzuar nga dita në ditë po mbetej pa mend nga sjelljet kaq «të shkëlqyera» të atyre njerëzve, në të cilat ajo nuk mundi të gjente asnjë njollë të zezë. Të gjitha këto binin në kundërshtim të plotë me ato që i kishte folur i ati për të kaluarën dhe për qëndrimin e familjes së Bajraktarëve. Dritës ju mbush mendja top se karshi atyre ishin marrë masa të padrejta, se ata ishin të dhënë me mish e shpirt pas mësimeve të partisë.

Kur Drita mendonte të kthehej në shtëpi, mbasi halla kishte dhënë shenja përmirësimi, ajo ishte afruar me Lamin, natyrisht pa hyrë në çështje dashurie. Lami e kishte mahnitur vajzën. Për çdo ditë

kishte ditur ta zbavitte me mënyrat më të stërholuara, saqë vajza arriti t'i thoshte Hiqes se Lami i pëlqente pa masë. Hiqja buzëqeshi dhe, duke lëpirë buzët si këpurdha të brymosura, i tha:

— Është fatmadhe vajza që ka për të pasur për burrë Lamin.

— Përse nuk është fejuar Lami? — e kishte pyetur Drita.

— Hi, hi, hi! — qeshi Hiqja. — Jo, moj mbesa e hallës, Lami është njëzet vjeç, po ku gjendet nuse për të! E lutin në të katër anët e krahinës, po atij nuk i hyn në sy asnjëra. Po habitem se si i kanë pëlqyer kaq shumë muhabetet me ty! Ai nuk begenis të kuvendojë me asnjë vajzë... Edhe ti, moj Dritë, e ke rradaken plot. I ke ngjarë gjyshit tënd, ndjesë pastë, prandaj Lami...

Drita u skuq nga një krenari që është aq gudu-lisëse për vajzat e reja e të padjallëzuara.

Dhelpra plakë e pikasi dhe sulmoi:

— Po deshe ti, unë mund t'ja mbush mendjen Lamit... megjithëse mësuesja e fshatit po i bie keq më qafë, sikur po e trullos, por, ku ajo, e ku ti!..

Zemrës së re, ku ngandonjëherë për arësye nuk ka portë, gjërat e ndaluara ja ka ënda. Rivaliteti shpeshherë shtyn vullnetet për vendime të shpejta... Prandaj Drita, kur mori vesh se mësuesja e fshatit ju vardiskësh Lamit, u dridhërua. Nëse gjer atëhere nuk kishte ushqyer ndonjë simpati të përcaktuar, tani filluan t'i ndizeshin shumë vatra në kokë. Këtë e kuptoi kur ndjeu se një rrymë urrejtjeje po ja kaplonte zemrën kundër mësueses së fshatit, edhe pse nuk e njihte.

Asaj mbrëmje Lami ja tha vetë. Aty ishte dhe Hiqja

— Vetë je e mençur, punët e tua i di më mirë se askush tjetër, por dije se për hera nuk të vjen e mira nga dera ... — i tha plaka.

Lami e pyeti vajzën me ngulm:

— Dritë, do të thuash «po», asgjë tjetër prej teje nuk dua.

— Thuaj, «po» mbesa ime — iu lut Hiqja duke rënkuar.

— Kushedi se ç'do të thotë babai?! — U përgjegj vajza me zë të shuar.

— Oh, babai, — ndërhyri Lami — ai është parimor, ai është njeri i lartë, ai as që ka për t'u bërë hendek i dëshirave dhe ndjenjave të tua... Thuaj «po», Dritë!

— Thuaj «po», mbesa ime, pash shpirtin e të ndjerit gjyshit tënd, shkrumbit të zemrës sime! Thuaj «po» se po të troket e mira te dera, hapja së mirës derën. Shtrija Lamit dorën dhe thuaj «po»! Drita, që ishte në të kapërcyer të pesëmbëdhjetave, tha një «po» me gjymës zëri.

Njëherësh, sikur të kishin qenë prapa derës, hynë në odë Zuni, Kalemi dhe Zyraja, e ëma e Lamit.

— Hë, ç'muhabet na bëkeni! — tha Zuni duke buzëqeshur me djallëzi dhe fërkoji atë syrin e verbër.

— Na qoftë për hajër miqësia, o Zuni i Bajraktarëve! Lami i Kalemit të Bajraktarëve, ai Lam që e lutën gjithë ato vajza dhe i përbuzi, sonte na u fejua — tha Hiqja.

— Lum nëna, e lumja! — shpërtheu Zyraja. Ajo edhe pse ishte rrahur kushedi sa herë nga i biri, u gëzua kur mori vesh fejesën e tij, edhe pse nuk kuptoi se cilat femra e kishin lutur djalin e saj dhe cilat ishin refuzuar.

— Kalem, kafetë! — thirri Zuni duke shikuar me atë syrin çakërr trupin e Dritës që po dridhej e strukur.

— Drita, — foli Hiqja duke rënkuar — ka frikë se mos do të bëjë fjalë i ati. . .

— Kush, Dan Rrushi? — tha Zuni. — Jo, ore, jo. Dan Rrushi është komunist. Si ka mundësi që një komunist të ngrihet kundra vullnetit të së bijës?!. Drita, kur të shkojë, t'ja thotë të atit, pastaj shkojmë ne dhe ja kërkojmë dorën. Kështu jemi në rregull edhe me vijnë, edhe me zakonin.

Të nesërmen Drita iku. E përcolli Zuni, ai gjithë rrugës e mësoi se si duhej t'ja thoshte të atit.

* * *

Drita nuk bëri ballë t'ja thoshte të atit, ja tha së ëmës.

— Nënë, unë jam fejuar.

— Lumja unë për ty, — qeshi e ëma e Dritës — paske përparuar në shaka!

— Nuk është shaka, po e vërtetë. Unë jam fejuar — përsëriti Drita seriozisht.

— Si, pa marrë mendimin tonë?! Kaq e vogël?! Me kë u fejove, bijë?

— Me Lamin e Kalemit të Bajraktarëve.

— Ah, ç'na thënke! — tha e ëma, por, kur pa se e bija mbante qëndrim si ndonjë e madhe, pyeti e shqetësuar: — Mos ke shkuar larg, bijë, në këtë marri?

— I kam thënë «po» dhe pikë!

— Po tjetër?

— Asgjë përveç po-së, po kjo është gjithshka për mua.

— Uh, të vraftë kokra e rrufesë! Po ti u marrose, a! Ç'pate?!. Kë më paske zgjedhur për dhëndërr, një këlysh shtrigash! — Dhe ja përmblodhi me shuplakë për herë të parë në jetën e vet. Atë fëmijë kishin, të parin dhe të fundin.

Drita as që lëvizi qepallat, ajo tha e vendosur:

— Edhe sikur të më mbytësh, unë fjalën e kam dhënë. Ata nuk janë ashtu si flet babai dhe ti, ata treten për partinë. . .

— Kush u tretka për partinë?! Këlyshët që i mëkon Zuni i Bajraktarëve, a? Na, që të pëlcasin! Na! Na! Na! E shtroi përdhe e, me një zemërim të shfrenuar, e qëllonte ku të mundte.

Në atë kohë hyri Dani. Shtangu në vënd.

— Kur të paskan lënë mendtë! Ç'bën, ashtu?! Mos vë dorë mbi vajzën, se për nder do të mi përlysh duart! — i bërtiti së shoqes i zemëruar.

Mirëpo Selvia e hallakatur nga zemërimi nuk hoqi dorë nga e saja.

Dani e shkëputi të shoqen me forcë nga e bija, e shtrëngoi me të dyja duart, e ktheu prej vetes, e shikoi drejt në sy, dhe e pyeti:

— Ç'ke, ç'ka bërë vajza?

Selvia, për habinë e Danit, ishte prishur në fytyrë, sytë i ishin shqyer e me gojë të shtrënguar tha:

— Për nder, do ta mbyt!

— Përse?

— Na është fejuar me këlyshin e Kalemit dhe të Zunit. . .

— Si?! — pyeti Dani që nuk po u besonte veshëve. — Drita jonë është fejuar me Lamin?!
— Po, Drita jote e dliirë, ylli!

Dan Rrushi që kurdoherë i merrte punët shtruar e çdo gjë përpiquej t'ja nënshtronte arësyes, u çakërdis. Po ky qe vetëm një çast. Ai e lëshoi gruan dhe u ul përtokë në prakun e portës së jashtme. Si u mendua ca, tha:

— Selvi, nuk duhet ta marrësh punën me ngut... Drita është rritur, ajo di se ç'bën. Nuk duhet të sillesh me vajzën në atë mënyrë...

Drita ngriti kryet dhe e shikoi të atin me njëfarë mirënjohje të përzier me dyshim.

— Dritë, — ju drejtua Dani vajzës, — shko lahu dhe nisu për në vatrën e kulturës, se të presin shokët dhe shoqet. Ata më porositën që të mos vonohesh.

Drita e trembur dhe e hutuar u la, u vesh dhe shkoi.

— Dani ja vuri së shoqes dorën mbi sup, e uli pranë vetes dhe i tha:

— Selvi, unë e kam fajin...

— Ajo bën budallallëqe dhe ti e paske fajin!

— Po, se e lashë të shkante në shtëpinë e Bajraktarëve. Mua kjo nuk më falet.

— Mos kujto se Drita ka bërë kushedi së çfarë me Lamin! Ata me dhelpëri ja kanë shkëputur një «po» dhe kjo kokëmushka...

— Dëgjo, Selvi, Zuni, e paska kurdisur mirë planin. Por ashtu qysh e ke filluar ti, në vend që ta shuash zjarrin, i fryn që të ndizet. Po vazhdove si e ke filluar, Drita mund të ikë te Lami. Neve s'na mбет tjetër veçse të hidhemi në Pellgun e Tënkuzës.

— S'e duroj dot një...

— As unë. Po fajin e kam vetë. Kësaj i thonë të bësh gjumë. Kjo nuk më falet.

Për nder kam për t'ja këputur kryet!

— Jo, grua, lypset të gjehet ilaçi.

— Më ilaç të mirë se druri nuk ka.

— Jo, jo — ngriti zërin Dani. — Dëgjo, lypset të marrim vesh se çfarë i kanë përrallisur për dy javë atje në kullën e Bajraktarëve, për t'ja arritur kësaj. Kur t'i marim vesh dhëlpëritë e tyre, është më lehtë të veprojmë. Dritën do ta bindin faktet se ka rënë në grackën e atyre që revolucionin tonë e kanë kripë në sy.

— Eh, mor burrë, zemra ngandonjëherë është shurdhmemece.

— Vajza jonë nuk është ndonjë qull e paformuar sa ta hajë sapunin për djathë. Ajo duhet të njihet mirë me të kaluarën. Të njohë më mirë se kush ka qenë dhe kush është Zuni. Po të arrihet kjo, do të shikosh se si ka për të vepruar vajza jonë.

Burrë e grua biseduan gjer në mbrëmje vonë. Kur u kthye Drita, u habit me qëndrimin e butë të së ëmës.

S'kaluan as dy javë dhe Selvia i kishte mësuar të gjitha djallëzitë që kishin përdorur Bajraktarët ndaj vajzës së padjallëzuar. Ajo ja tha të shoqit. Danni qeshi hidhur dhe tha:

— Kjo s'më çudit. Ujku qimen ndërron. . .

Pas ca javësh erdhi Zuni dhe kërkoi dorën e Dritës. Ai, duke menduar se e kishte marrë kalanë nga brenda, ishte folë e qesh, me gjithatë shumë i matur në ato që nxirrte nga goja.

— Edhe pse për punën e fejesave, — hapi bisedën Zuni — duhet të merren vetë personat, domethënë djali dhe vajza, kjo është një gjë shumë e vyer, i qofshim falë partisë, prapë them unë, ndoshta e kam gabim, them unë. . . meqë jemi miq të vjetër, duhet të ketë burra midis fjalësh. . .

— Jo besa, o Zuni i Bajraktarëve, — i pat thënë Dani — unë nuk e kam ndër mend t'i përzihem vajzës në punët e saj. — Dhe shikoi me vërejtje efektin që bënë fjalët pasqyruar në fytyrën e Zunit, i cili fërkoj syrin e verbër dhe u lëpi kënaqshëm.

— Drita — vazhdoi sërishmi Dani — thotë se nuk do të fejohet...

— Si? Qysh? — pyeti i habitur Zuni.

«Eh, dhëlpër dinake, bluante me vete Dani, ju jeni kalbësira. Do të bëj unë që të vërtitesh si majmuni kukull në duart e ustait».

— Pse, a nuk ju ka... — bëlbëzoi Zuni e pastaj dredhoi. — A hiç nuk e ka ndër mend të fejohet bija juaj? Kjo është fatkeqësi!

— Ç't'i bësh, o Zun, është e drejta e saj, ndërhyrjen nuk ja lejoj vetes...

— Besa, kjo duhet të të shqetësojë...

— Ma ha mendja se ajo e ka rregulluar me një shok të shkollës...

— Me cilin? — brofi në këmbë Zuni. — Fjala nuk u jepet shumë njerëzve. Gruaja merr një burrë...

— S'po të kuptoj, o Zun!

— Po ja, ju herë thoni se nuk do të fejohet, herë se e ka rregulluar me një të shkollës...

— Ajo është puna e saj.

— Unë kam ardhur për këtë punë...

— Zun, fejesë me shkesë nuk bëj unë.

— Po pyet një herë vajzën, he burrë!

— Ajo duhet ta gjejë dhe të më pyesë mua.

— Ndoshta e ka gjetur...

— Atëhere prashitim në ujë.

— Dëgjo, or mik, ajo ja ka dhënë fjalën Lamit tim.

— Ashtu, atëhere përse i biem legenit?! E di mirë këtë?

— Ohua, shumë mirë bile.

— Punë e mbaruar qenka! Përse më vërtit jo dua dorën, jo tërti-vërti!

— Domethënë...

— Dëshirën e vajzës s'e lot as topi.

— Atëhere na qoftë për hajër ripërtëritja e mi-qësisë! — tha Zuni dhe lëvizi nga vendi.

— Unë as që i ndërhyj vajzës....

— Qofsh faqebardhë! — tha Zuni dhe u ngut për rrugë.

Në shtëpinë e Bajraktarëve tri ditë nuk pushoi ahengu.

* * *

Pas tre vjetësh, kur Drita kishte kryer shkollën dyvjeçare dhe po mbushte vitin në punë, i kishte dalë përpara Lami i Bajraktarëve:

— Si je, Dritë? — i kishte thënë ai. — Më ka marrë malli...

Drita e kishte shikuar me neveri. Ajo brenda atyre tre vjetësh kishte mësuar mirë se kush kishte genë dhe kush ishte Zuni dhe se Lami ishte pas-ardhës i denjë dhe besnik i xhaxhait. Asaj i kishin folur edhe kushërinjtë, bijtë e Hiqes, që e kishin braktisur prindin e mykur. Ajo nuk gjente mjet për t'u hakmarrë për mashtrimin që i patën kurdisur dhe e gjykonte veten rëndë për atë lajthitje. E shikoi Lamin që ja kishte zënë rrugën dhe i erdhi t'i hidhej me thonj në fytyrë.

— Folë, — i tha Lami — kam zbritur nga malësia, kam udhëtuar natën vetëm për ty. Mua më prite? Ti qenke rritur, qenke zbukuruar edhe më shumë... Kaq kohë të fejuar, sa keq nuk jemi parë! Ende na pengojnë mbeturinat... Folë ndonjë gjë! Ti më pe mua dhe prite? Apo?..

Në atë kohë po vinte Dritani, që ishte ndaluar prapa me një shok. Ai ja futi krahun Dritës, pa e vënë re Lamin që qëndronte midis rrugës si ndonjë hu.

Drita shtriu hapin, pa kthyer kokën prapa.

Lami shtrëngoi grushtat. Zemërimi po ja errësonte pamjen. Po frika, ajo frikë që i bën ujçit qengja, e frenoi të hidhej në sulm.

— Ah, bushtër, — bërbeliti ai në drejtim të pacaktuar — bushtër! Ke për të parë se kush jam!.. — U kthye nga ana e kundërt. Në fillim eci, pastaj vrapoi. Pa e marrë vesh as vetë, ai kishte ecur e vrapuar sa ishte bërë shkumë i tëri kur mbërriti në fshatin e largët malor. E gjeti Zunin dhe ja tha me një frymë, Zuni u bë spec, u ngrit dhe shikoi poshtë kullës:

— O zot, gjer ku do të ulim kryet ne, bijtë e Bajraktarëve! Nuk durohet më, po na shkelin siç shkelen krimbat! Kë? Ne që dikur... Nuk durohet...

— Xhaxha, — i foli Lami — mos u ngut, lypset t'i kesh parasysh porositë e fundit të misionarit, sot për sot ajo është mënyra e vetme e luftës sonë, se ndryshe s'kemi sesi. Me forcë nuk bën. Ti vetë më ke mësuar: «Mishi të piqet, helli të mos digjet».

— Dëgjo, Lam, — tha Zuni — unë nuk mund të lejoj që të më marrin kaq turpërisht nëpër këmbël! Unë do të bëj që vajza e Dan Rrushit...

— Mos u ngut, xhaxha — ju lut Lami se ishte i bindur që xhaxhai i tij ishte i madh në prapësira dhe se kishte shpresë mos sërishmi e rregullonte me Dritën, së paku ta rrëmbente...

— Mos u ngut thamë vitin e parë të këtij pushteti, se nuk e ka të gjatë... Mos u ngut vitin e dytë! Mos u ngut vite me radhë! Po qelbemi duke pritur, kurse këta... Bija e Dan Rrushit natën e parë të martesës ka për t'u shtrirë në qivur! — Kështu tha Zuni i Bajraktarëve.

Të nesërmen e dërgoi Hiqen te Dani, të cilën nuk e kishin pranuar as të hynte brëndë.

Zuni e kishte parashikuar këtë gjë. Sapo u kthye Hiqja, ai filloi ta zbërthente planin e kurdisur. Mbase e ndërseu mirë e mirë kundër të vëllait dhe, kur pa se shpirti injorant po pasqyrohej në damarët e mavijosur, natën vonë, kur të gjithë kishin rënë në gjumë, Zuni ngriti rrasën e oxhakut. Andej nxori një arkëzë të metaltë; e hapi dhe nxori dy shishe sa një llullë duhani. «Këto mbjellin vdekjen e një taborri ushtarësh», tha me vete. Lulja duhet përvëluar në kohën e lulëzimit, se hakmarrja ashtu gjen karar, se zemra e zhuritur ashtu balsamohet...

Pas një muaji Dan Rrushit martonte të bijën. Për habinë e të gjithëve ai thërriste në dasmë të motrën, Hiqen.

Zuni i tha Hiqes:

— E rregullova me shumë përpjekje që Dani të thërriste në dasmë. Dihet se me gruan shkon dhe i shoqi... — Dhe mendoi: «Tani na erdhi radha neve. Ta shuajmë buzëqeshjen pa u hapur mirë buzët. Ta kthejmë dasmën në mortje. Kështu do të hakmerremi për të gjitha. Bile pa asnjë therrë në këmbë. Mishi piqet, helli nuk digjet...»

Këto kujtoi Zuni i Bajraktarëve tek po zhgërryhej te grunajet. Pastaj u ngrit dhe filloi të vraponte si ndonjë derr i egër. Diku rrëzë malit u ndal. Kërkoj me duar të dridhëruara dhe ndezi një cigare: «Ah, të kem e ta shkurtoj këtë gjuhën time që llapi aq shumë! Njëzet kusur vjet e mbajta të kyçur të shkretën, kurse sonte! Ah, ç'më bëre, moj gjuhë rebele!..» Duke prekur në fund të xhepit, i takuan majat e gishtërinjve shishen e vogël sa një llullë duhani. Ju kujtua pronari i asaj arme të pazë. Ai i kishte dhënë shumë të tilla më ditën e fundit, kur s'kishte vend më për atë person. Atë natë pat ikur i shastisur, sepse u kishin pëlcitur minat ndër duar. Me të e me ndonjë tjetër Zuni që takuar në rrethana shumë të rrezikshme për kokën. Atëhere mori edhe udhëzimet e fundit, sepse i thanë se më lehtë ishte të zbriste në diell se sa në Shqipëri. Ajo natë ju kujtua Zunit, ishin takuar në një guvë, në errësirë. Ato i dhanë zemër dhe i thanë se Zuni i Bajraktarëve për ta ishte e vetmja kartë e padjegur, se shpresat nuk duheshin humbur, se Zuni lypsej të forconte miqësinë me të kunatin, Dan Rrushin, e me njerëz të tjerë si ai, se duhej të merrej me sabotime, shkatërrime, për të ngjallur pakënaqësi te populli, për të mbajtur të ndezur shpirtin e të pakënaqurve. Po pastaj. Eh, pastaj ku pyet luani për pickimin e mushkonjave. Ata dy persona e kishin mbushur me shpresa. Zuni e kishte kuptuar se ata që i flisnin as vetë nuk u besonin fjalëve të tyre, megjithatë bajraktarit asnjëherë, nuk ja desh shpirti që të besonte në një përndim të përhershëm.

Zuni e rrotullonte shishen nëpër duar dhe va-

zhdonte monologun e tij tragjik: «Unë duhej t'ua hidhja në pije atyre që më përzunë si ndonjë qen! Ah, moj gjuhë, qofsh mallëkur!..» Kështu sokëllinte Zuni i Bajraktarëve dhe rrotullohej rreth vetes si ndonjë qen i tërbuar...

II

Sapo e përzunë Zunin e Bajraktarëve, dasmoreve u qeshi fytyra. Gjer atëhere ata që e njihnin Zunin, e kishin ndjerë veten si mbi gjemba. Bile plaku Lim, siç e tha më vonë, kishte vrarë mendjen të gjente se përse e kishte ftuar Dani atë, që midis të tjerëve ngjante si ndonjë çiban mbi një trup të shëndoshë.

Drita u kthye nga dhoma e veshur nusërishte, e përcjellur nga shoqet. Sapo bëri ballë në prakun e dhomës, të gjithë u ngritën në këmbë, tokën dollitë dhe i çuan me fund. Nusja u ul pranë dhëndrrit.

Tingujt e daulles dhanë sinjalin. Buçiti orkestra e kooperativës. Selvia, e ëma e Dritës, i përcillte të tilla shikime së bijës, në të cilat përmbledhej e tërë lumturia që provon njeriu në të tilla raste. Kur muzika bëri një pauzë të shkurtër, ajo ju drejtua dhëndrrit:

— Dritan, ngutu e pi edhe ca gota, se po të pret përparësja... Ju martoheni, dhe ne t'ju shërbejmë, ku është parë!

Të gjithë qeshën. Dritani ju përgjegj shakasë me shaka:

— Shoqja Selvi, nëse nuk kundërshton jot bijë, unë jam gati. Po shiko si më ka kapur ajo për mën-

ge dhe nuk lejon që të zbatohet urdhërat... Mos ki merak, se qysh nesër do t'ja rregulloj kësaj vajzës sate, as kam për ta lënë të shkojë për qumësht, as për zarzavate; le të çirret sa të dojë. Po e teproi në shamatë, edhe gjellën do ta bëj vetë...

— Hë, të lumtë, sa mirë dashke t'ja punosh! — tha plaku Lim duke qeshur. «Çfarë të pacipë! Bubu, çfarë të pacipë! Si po i duron dheu!» mendonte dhe mallëkonte plaka Hiqe atje në qoshen e dhomës.

DAVA

Rifilloi muzika. Midis portës dhe tryezave u krijua një shesh. Sorkadhja, sekretarja e rinisë, i bëri shenjë Dritës. Kjo u ngrit e mori për dorë Dritanin. Filloi vallja. Udhëhiqte nusja. Këmbët ndërroreshin me shkathtësi e lehtësi. Lëvizje të këndshme, në fillim të lehta, të ngadalta, të matura, pastaj të vrullshme, të shpejta. Djemtë u shkëputën dhe krijuan një rreth, midis të cilit vajzat si fluturat kërcenin. Djemtë mbanin rritmin duke rrahur shuplakat.

Vallja mbaroi, valltarët po uleshin nëpër vende duke i bërë freskë fytyrës me duar. Hallë Dava u ngrit më këmbë. Me shikimin e saj që përcolli te të gjithë të pranishmit vendosi qetësinë. I buzëqeshi Sorkadhes që ishte kryetare e mbrëmjes edhe tha!

— Kam një lutje...

— Oj, motër, — ja ktheu Hava — ti as në kohën e Noes nuk je lutur! Ç'të qenka tekur sonte, që, edhe sikur të duash, s'ke se ku të falesh, se këta të rinjtë e pafe i kanë prishur edhe kishat, edhe xhamitë.

Të gjithë qeshën, disa duartrokitën. Po Dava me shikimin e saj prapë vendosi qetësinë e tha:

— Kam një lutje...

— Do të ta plotësojmë — thanë shumë zera.

— Kërkoj nga solistja të na këndojë atë këngën... si i thonë: «Jam e fejuar qysh më djep...»

Dani dhe plaku Lim ulën kokën të mallëngjyer. Orkestra ushtoi, zërat u përhapën sikur buronin prej dheut, pastaj u ngritën sikur përqaftuan tavanin, u derdhën edhe jashtë dritareve të hapura:

«S'ma falin prindët djalin që dua me shpirt...»

Bashkë me tingujt që fluturonin jashtë dritareve, edhe kujtimet e Davës morën udhë, përshkuan mugëtira dekadash, zunë fill tutje kasolles me atë trungun e gorricës që ngrihej e kapërthyer mbi shkurret rreth ë qark.

...«Eh, mendoj Dava, nuk ma fali koha djalin që desha me shpirt...»

Kënga vazhdonte, kujtimet e Davës vraponin tutje në kohën e rinisë së mugulluar:

.....

Pranverë e zyrtë. Bilbilat çukitnin gjembat e ferrave. Fyelli i një çobani ja thoshte një melodie vajtimtare. Vajza që kishte shkelur në të gjashtëmbëdhjetat, duke mbuluar me dorën e djathtë këmbën e grisur atje ku gjoksi ngrihej me gjallëri, më të majtën hiqte për kapistre lopën gërdallë. Ngrinte kokën mbi shkurre, e joshur nga melodia e nga ai që e luante melodinë. Ajo s'desh t'ua dinte as gjembave që ja shponin këmbët e zathura, as ferrave që e gërvishnin, as lopës eshtake që turhaste

besdisshëm, as syrit të keq që, i strukur atje ndër kaçuba, mund të përcillte në mënyrë tinzare, pastaj të vraponte atje në fshatin e largët dhe ta njoftonte atë... pronarin, të fejuarin e saj që e priste nusen qysh trembëdhjetë vjet përpara. E ai mund ta rrëmbente, të lante nderin me gjak. Jo, zemra ndër jetë të jetëve e ka dashur lirinë. Ajo ka rëfketirë nën forcat e errësirës, por lirinë e ka dashur; ajo është dridhëruar nga forca e grushtit të pamëshirshëm, po për lirinë ka qenë e zhuritur; ajo është trandur nën zjarrin e etheve të ngulfatjes, por dëshirën për të thënë fjalën e vet e ka ruajtur në skajet më të fshehta saj.

Gjashtëmbëdhjetëvjeçarja sikur shtyhej nga forca e gjashtëmbëdhjetë pranverave të kyçura në shpirtin e saj, të cilat sikur njëherësh shpërthenin dhe lulëzonin. Mbase kaloi pllajën e kapërthyer me shkurre e driza, atje te një prozhmë rrëzë zabelit e pa atë të mbështetur mbi kurrizin e një lisi të trashë, me kryet pak të përkulur. Mbi gjuhëzën e fyellit ai i këndonte varfërisë dhe dashurisë së vet. Vajza filloi të lidhte lopën në degën e një murrize, por, ndërsa ajo ishte kërrusur dhe ngutej se nuk po i pritej sa t'i afrohej atij në befasi, një krismë pushke si ndonjë klithmë kobëzezë rënkoj përmes luginës. Vajza u shtri përdhe prapa kaçubave. Me ankth shikoi andej nga lisi dhe vërejti. Ah, ç'vuri re!.. Bariu u rrokulis mbi fyell, melodia u këput përgjysmë. Zogjtë e trembur fluturuan të shpërndarë. Dy korba, duke krrakitur, u ngritën me përtim në qiell. Dy njerëz me rroba dhe armë të zeza dolën gërmuç nga zabeli. Duke shikuar rreth e qark, ju afruan djaloshit, e rrotulluan, çuquritën diçka vesh më vesh, prapë gërmuç u fshehën në zabelin e dendur. Plakosi heshtja.

Dëgjoheshin vetëm tringëllimat e ziles së cja­pit.

Vajza harroi të mbulonte gjoksin. Përmes të grisurave të këmishës nxorën krye dy si ftonj të posa rënë lulja. Vrapoi e lebetitur dhe kuturu. Me një frymë u gjet pranë djaloshit. Ç'të shikonte. Djaloshi ishte shtrirë i zverdhur, me një­rën dorë mbi gjoks, mbi një zgavër që ende i gurgullonte i kuq gjaku; në tjetrën dorë i ishte ngurosur fyelli në grushtin e mbledhur. Në veshët e vashës ende kumbonin tingujt e fyellit, pastaj me ta përzihej krisma e pushkës. Kjo përzierje tingujsh u kthye në goditje si me çekan mbi kokën e vajzës. Ajo ndrydhi tëmthat me të dyja duart. Sytë, ata sy që më parë shkëlqenin nga një gëzim i brendshëm, nga dëshira e madhe e një takimi, u zmadhuan, u errësuan, në ta u pasqyrua fytyra e djaloshit e mbërthyer nga ngërçi i agonisë së fundit. Në buzët i ishte ngurosur buzëqeshja e ndërprerë, një buzëqeshje e këputur, një buzëqeshje nga currielonte i kuq gjaku. Ishte përgjakur buzëqeshja.

Vajza e trullosur, e mpirë nga ankthi për lumturinë e grabitur, u përku­l, me dorën e dridhëruar fshiu këndin e buzës së djaloshit nga nxirrte krye një fill gjaku, pastaj vuri buzët mbi ato të djaloshit. Burimi nga mund t'i dilnin lotët kishte shteruar shumë kohë më parë, që kur e gërryente uria e nëna s'kishte një kore bukë për t'i dhënë, që kur mërdhinte së ftohti, e nëna s'kishte një palë opinga, ose një triko makar prej leshi të dhisë që ta ngrohte, që kur rropatej tërë ditën me lopën e beut dhe nuk guxonte një herë të thoshte se ishte lodhur.

Ajo u bë njësh me bariun, të cilit plumbi ja kishte fikur rininë dhe ja kishte grisur dëshirat. Vajza thirri me zë: «Malo, Maloja im!» Pastaj uli zërin,

sikur të frikësohej mos e zgjonte nga ndonjë kllapi ëndërrimtare... Ndërsa po qëndronte e kapluar me trupin e djaloshit, befas ndjeu një goditje të fortë prapa kokës. Vajza mbylli sytë... Diçka si ndonjë përbindsh në ndonjë ëndërr të llahtarshme e mbërtheu trupin e saj llastar, sikur e hodhën në një kazan zifti të përvëluar. Vajza gjendej në një gjendje kllapie, mirëpo për çudi vetëdija e alivanosur i punonte me zvarritje.

Një përfytyrim e errët zvarritej në mendjen e gjashtëmbëdhjetëvjeçares:

...Zabeli. Rrëzë zabelit Maloja. Maloja i mbështetur mbi kurrizin e lisit të trashë këndonte një melodi me fyell. Vajza heq për kapistre lopën gërdallë të zotërisë. Melodia ja gudulis zemrën. Me dorën e lirë ngre një fill flokësh që i ishte shprishur nga bishtaleci. Vajza tërhiqet nga lopa, e cila e uritur hiqej me mundim nga disa tufa bari që kishin nxjerrë krye mbi kaçubat e rrumbullakëta. Dy duar e mbërthejnë për beli. Një puthje e përvëluar nën gushë.

«Mos, Malo, mos!» Kur kthehet prapa, djaloshi kishte ikur. Vajza ngre dorën dhe lëmon vendin nën gushë, mundohet t'ja fshehë buzëqeshjen vetes.

Të nesërmen në mëngjez sikur e tërhiqte me forcë ai vend. Dielli po i shponte drurët e zabelit me rrezet e tij. Vajza me lopën për dore çapitet përmes shkurresh. Pas pak përhapen tingujt e ëmbël të fyellit. E fut lopën në përroin e mbyllur me gjelbërishte. Fërkon faqet me duar. Nga prapa kurrizit të saj dëgjohen hapat e lumturisë. Dy duar ja mbyllin sytë, një zë i dridhëruar, plot belbëzime, thotë:

— «Davë, unë ty të dua! Martohemi bashkë, Davë?»

— Edhe unë ty të... , ju hap goja Davës, po mua më kanë fejuar qysh të vogël.

— Davë, unë ty të dua pa masë! — tha djali dhe u zhduk prapa kaçubave. Davës i fliste zemra, por goja i ishte kyçur.

— Edhe motra jote, Hava, ishte e fejuar, foli Maloja prapa kaçubeve, — po ajo mori atë që ja desh zemra...

— E mori, — u përgjigj Dava, — por për shkak të asaj babai vari veten..., gjaksi nuk mbeti pa grua, mori motrën e mesme, Hiqen. Po të martohem unë me ty, s'kam motër tjetër që ta marrë ai që më ka blerë përpara trembëdhjetë vjetësh. Po të ma vrasin të vetmin vëlla, Danin, do të të vrasin edhe ty...

Davë, unë ty të dua, po më deshe, unë të rrëmbej...

— Mos ma shkatërro zemrën, Malo!

— Të dua, Davë.

— Edhe unë ty të dua, Malo, por a mos ma shkatërro zemrën, jam jetime e pambrojtur... Nëna me sot e me nesër mund të na vdesë...

Shkurret lëvizin, del Maloja ballë për ballë. Vajza mbyll sytë me duar. Djali e mbërthen dhe e mbështet në gjoks. Të dy të mbërthyer nga flakë të brendshme shtrihen mbi barin e njomë. Symbyllur përqafohen.

Vonë lopa e zotërisë pëlliti andej nga fundi i prozhmës. Të rinjtë të skuqur në fytyrë mezi ndahen.

Në mbrëmje Dava ja hap zemrën së ëmës. Të sëmurën e mbërthen një kollë frymëmarrëse. Pastaj lëviz buzët thujse pa jetë: «Davë, bija ime, ki më-

shirë për tët vëlla. Po ta bësh atë që ke ndërmend, dije se kanë për të vrrarë edhe Danin, edhe Malon. Ja u rrëmbye Hava, vari veten babai, vranë dy nga dajat që ishin dorë zënës për borxhin që kishin marrë prej Bajraktarëve. Hava s'dihet nëse jeton apo ka vdekur... Ne femrat na mallëkojnë qysh kur shohim rrezën e parë të dritës. Sot nuk gjen femër që të mos e ketë zemrën, të zhbiruar nga vuajtjet dhe mjerimet. Unë sot jam, nesër s'jam. Ki mëshirë për tët vëlla...»

Dava qau bashkë me të ëmën. Ato, të përqa-fuara derdhën lot të përbashkët, të cilët ridhnin sikur deshën t'i freskonin zemrat e zhuritura.

Disa ditë më vonë Dava u takua me Malon. Takimet shpeshohen. Siç i thonë fjalës «Fusha ka sy e mali ka veshë». Në katund filluan të përshpëritnin: «Dava e Cenit e ka rregulluar me Malon e Bimit». Por nga fjalët nuk shuhen zjarret.

Kur përfytyrimet e kalamendura të Davës po i afroheshin caktut të fundit, një përplasje. Asaj i doli kllapia. Hapi sytë dhe pa se ishte e mbyllur në një thes që i ngjante një kashtoreje të madhe. Pastaj dëgjoi dialogun e atyre që e kishin grabitur:

«Rremë, është gjallë?»

«Gjallë, gjallë është, o Seit...» u përgjegj ai që e quanin Rremë.

«Rremë... Rremë... goditi kjo fjalë në mendjen dhe zemrën e Davës, Rremë... , ku e kam dëgjuar këtë emër? Rremë... Rrema asht ai për të cilin më kanë blerë... Ky qenka Rrema?! Ky pra e paska vrrarë Malon! Duro, zemër! Duro!»

E mbërthyen thesin e madh sa një kashtore. Da-

va dëgjonte vetëm frymëmarrjen e rëndë të atij që e mbarte mbi kurriz.

Natën vonë u hap gryka e thesit. Dava pa një dhomë pa tavan me një vatër në mes. Një plakë me sy të fjetur, më tutje dy burra me mustaqe, që të dy dukeshin pleq. Ata përshpëritën diçka njëri me tjetrin e dolën duke e kyçur derën prapa vetes.

— Trupin s'ta mbulokan lekat — foli plaka me sy të fjetur. — Të qenka tekur ta luash bishtin. Nuk t'u kujtua se ti ishe e shitur?! Hajde, ngrehu! Duhet të bëhesh nuse!

Davës i gufoi një e qarë dhe dëneseje e mbytur.

— Mos mendo për gjë tjetër! Bëj atë që të thonë, — urdhëroi plaka me sy të fjetur, — se pastaj do të ta punojnë si mua në një kohë... Ti s'ke pse mendohet hiç, mendojnë të tjerët për ty! Çohu!

Kur e veshën dhe e bënë nuse, erdhi një plak me sy të shqyer:

— Unë jam vjehrrri yt, — i tha ai Davës, — kemi dëgjuar fjalë të këqija... — aq më keq për ty... — Kaq tha plakë dhe u ngrit e doli.

Davën e dërguan në dhomën e saj. Të gjitha ato që e rrethonin Davën i dukeshin të çuditshme — fytyra të përvuajtura me lëvizje të ngathëta. Çdo gjë të jepte përshtypjen e një varrimi.

Natën vonë dolën të gjitha gratë nga dhoma. Hyri Rrema:

— Ja shtroja, — i tha ai — shtriu!... — Pastaj u zhvesh. Dava pa ca damarë të mavijosur, lëkurën e bardhë me qime të rralla që i kujtuan një pulë të rjepur. Dava ishte shtangur atje mbështetur për muri. Rrema e përfshiu për krahësh dhe e përplasi në

shtroje. Me duart e ashpra e zhveshi, pastaj e shtrëngo-
goi midis gjunjsh dhe filloi ta puthte. Dava, nëse
gjer atëhere ishte si e mpirë, pështirosja e zgjoi. E
shtyu, por shumë grushta ju derdhën mbi kokë, ku-
rriz, ije. Kur Dava u shtri e këputur, filluan sërishmi
puthjet... Pastaj përplasja në cep të shtrojes. Gër-
hitja e Rremës

* * *

Babain e Rremës e quanin Sal Kokordhoku.
Familja e Salës, qysh ditën kur vranë Malon e Bimë
Thanës, u mbyllën, se kishin rënë në gjak. Maloja
kishte lënë prapa tre vëllezër më të mëdhenj. Fa-
milja e Bimë Thanës ishte në të njëjtën gjendje
ekonomike me atë të Salë Kokordhokut. Kishin ve-
tëm një ndryshim: Bimi me të bijtë punonte në to-
kat e beut, kurse Sala kishte dy rrypa toke aq sa të
mos i degdiste djemt në kurbet, megjithëse nuk
mund të siguronte bukë as për tre muaj. Po, meqë
Bimi nuk kishte tokë të vetën dhe punonte në tokat
e beut, llogaritej një shkallë më poshtë. Kështu i kon-
sideroi edhe Salë Kokordhoku. Mbas gjashtë muajve
të vrasjes së Malos, burrat e Salës filluan të dilnin
në punë, bile edhe të shkonin në pazar pa kërkuar
besë nga Bimi.

Salë Kokordhoku i kishte dërguar kurdoherë nje-
rëz Bimit për t'u pajtuar, por Bimi i kishte kërkuar
shkakun e vrasjes e Sala nuk ishte në gjendje të blin-
te një tjetër grua për Rremën, prandaj nuk i tregoi
përse kishte kryer krimin, sepse Sala nuk desh të

nxirrte në shesh çështjen e nderit të së resë së vet, pasi asistoi sipas kanunit ai duhej të vriste edhe nusen. Kështu as i dërgoi Bimit njerëz për t'u pajtuar, as për të kërkuar dalje me besë.

Pas nëntë muajsh Davës i lindi një djalë. Kjo foshnjë që i vetmi ngushëllim për nusen e re. Dava harroi se kishte për burrë një pesëdhjetëvjeçar, një burrë që edhe në kohën e shtatzanërisë e pat rrahur dhe torturuar si mos më keq. Lindi pra nyja që e lidhi Davën me atë kullë me mure e shkallina prej guri.

Djalit të Davës ja vunë emrin Qesat, se kishte lindur në vitin e zisë së bukës. Kur mbushi tre muaj dhe filloi të bëlbëzonte, mbi kullën e Salë Kokordhokut pëlciti një mynxyrë.

Ishte dimri i vitit 19. Malet ishin rënduar nga bora. Tagrambledhësit kërkonin taksa. Në magjet e fshatarëve miu thyente kokën.

Mbrëmje e zymtë me suferinë nga të katër anët. Dava e kishte mbështjellë foshnjen në një përparëse e po i jepte sisë. Tri krisma pushkësh u dëgjuan andej poshtë te gardhi. Qesati i vogël u përpëlit në prehërin e nënës. Sal Kokordhoku doli me të bijtë. Pas pak u kthyen. Në duar mbanin trupin e Rremës që kishte vdekur.

Dava nuk qau. Ajo shtrëngoi foshnjen në pëqi. Shtrëngoi nyjen.

Të nesërmen hapën tokën e ngrirë, varrosën Rremën që e kishin shpuar tre plumba tej e tej.

Një mbrëmje, dyzet e një ditë pas vrasjes së Rremës, ndërsa Dava ishte struktur në dhomën e vet me të birin e saj, i cili mërdhinte e ajo ja hukaste doçkat, u dëgjua një rraptimë në shkallët e gurta të

kullës. Kërciti dera e trashë prej dërrasash të pastru-
guara. Brenda u fut vjehrra me sytë e fjetur:

— Nuse, — i tha ajo Davës — më jep djalin!

— Pse? Pse djalin?! — pyeti Dava e shqetësuar
dhe e mbuloi fëmijën me trupin e vet, ashtu si mbu-
lon shqiponja zogjtë kur i kërcënon ndonjë rrezik.
Plaka me sy të fjetur e mbërtheu Davën për supesh
dhe i tha:

— Më jep djalin. Të kam thënë se të tjerët men-
dojnë për ne. Ne jetojmë vetëm për të zbatuar
urdhëra. . .

— Ku do të ma çoni djalin?

— Do ta mbaj në dhomën time, se këtu bën
ftohtë! — tha plaka dhe e rrëmbeu foshnjën.

Dava prapë dëgjoi rraptimën e këpucëve të druj-
ta mbi shkallët e gurta.

Nuk vonoi shumë dhe në dhomë u fut Salë Ko-
kordhoku:

— Nuse, — i tha ai Davës — burri t'u vra, qofsh
vetë shëndoshë! Ti je e re. Nuse të tepërt për të
nxjerrë nga konaku nuk kam. Qysh sonte do të mar-
tohesh me birin tim të vogël, me kunatin tënd,
Ramën. . .

Dava u mblodh kruspull, futi gishtat në gojë dhe
i kafshoi, u hoq këmba doras gjer në qoshen e dho-
mës:

— Si! . . Qysh! . . Unë . . . Unë . . . Ramën e kam. . .
Rama është vëllai. . . Unë kam djalin. . . Për hatër të
djalit do të bëhem shërbyesja e të gjithëve. . . — Ndër-
sa Dava po fliste e hallakatur nervash, këpucët e
drunjta kërcitën mbi shkallët e gurta. Salë Kokor-
dhoku zbriti në kthinën e vet.

«Do të hidhem prej kullës! Do të. . .»

Porta u hap me rrapamë, në dhomë hyri Rama,

u zhvesh, ju afrua Davës, e mbërtheu për duarsh dhe i tha:

— Nuse, mos bëj naze, me pare të shtëpisë të kemi blerë. Qysh sonte ti je gruaja ime!

— O Ram, im kunat, të lutem... Unë kam djallë... Unë do ta ruaj... atë! Ram, im kunat...

— Jam burri yt — tha Rama. E përfshiu për beli dhe e shtroi nën vete.

Dava shkulte flokët, kafshonte buzët...

Kaluan shumë vite. Vite të thinjura nga skamja. Dava u bë nëna e tre kalamajve.

Kur trualli i shqipeve rënkonte ethshëm nën shtypjen e çizmes së zezë, kur sokolat e partisë ngrihën foletë e tyre në malet shqiptare, Dava përcolli të tre djemtë e saj.

«Ju kam rritur për këtë ditë, o bijtë e mi! Mendoni dhe kujtoni vuajtjet e nënës suaj, se keni për të qenë më të fortë, më trima në luftë! Udhë e mbarë! U kthefshi faqebardhë!

Shtëpia e Ram Kokordhokut u kthye në bazë ku strehoheshin dhe ushqeheshin partizanët.

Djemtë e kryen porosinë. Më i vogli ra dëshmor. Nënë Dava nuk qau: «Për Atdheun, për mua dhe për të gjitha të vuajturat nga shtypja si unë ka rënë!» tha ajo.

Rama, burri i Davës, vdiq i internuar në kampet e Hitlerit.

Davës së thinjur, Davës së shumëvuajtur, ju kthyen dy djemtë bashkë me fitoren.

Dava, grua dhe nënë dëshmori, nëna e partizanëve trima, braktisi kullën e gurtë. Për herë të parë në jetën e saj i qeshi buza në një shtëpi të re.

* * *

Kënga që kish porositur Dava, kishte kohë që kishte mbaruar. Dava, kur u shkund nga kujtimet, pa se dhjetëra sy i ishin qepur asaj, u skuq, rrëmbeu gotën dhe tha:

— Ta çojmë këtë gotë për jetën tonë të re, për lumturinë tonë!

H A V A

Sorkadhja me gotën në dorë u ngrit më këmbë e tha: «Këtë gotë do ta ngremë për veteranën e Luftës nacionalçlirimtare, për ish zëvendës komandan-ten e çetës partizane, për ish-komandan-ten e disa brigadave aksioniste, për komunisten e vjetër, Hava Rushi.

— Shoqja Havë, — ju drejtua asaj plaku Lim — jetë të gjatë, të të rrojë vajza, të trashëgohet mbesa jote, Drita!

— Havë, motra ime, e ngre këtë gotë për vuajtjet e tua në të kaluarën! — uroi Dava.

Hiqja lëvizi atje në qoshe: «Të gjitha i bëjnë që të ma pëlcastin zemrën mua. Askush s'më përfill, askush s'më do... Të gjithë këta që po gajasen kanë çfarë u do zemra... Mua ma morën tokën, bagëtinë... Më urrejnë edhe djemtë që më braktisën! Edhe ata m'i ka helmatisur me farmak kundër meje Hava, Dani... Të gjithë këta... S'ka gjë... Unë nuk duhet të rri duarkryq. Unë...»

Me atë hallakatje nervash u ngrit në këmbë, me sytë e vegjël zgjodhi vendin se ku do të ulej e tha:

«Eh, Dan Rrushi, motrën e mesme, hallën e Dritës e harruat. Një pjesë për gëzimin e mbesës sime më takon dhe mua. E lejoni këtë plakë të braktisur nga çdo gëzim, nga gëzimi dhe lumturia që ja grabitën ose ja shkatërruan ato që po pinë këtu me ne. . . E lejoni plakën e braktisur edhe nga fëmijët e vet që të ulet pranë mbesës së saj?

— Tezja Hiqe, ku dëshiron të ulesh — pyeti Zijai, i biri i Davës.

— Afër Dritës, or bir i tezes.

— Eja pra ulu midis Dritës dhe Havës.

— Jo, afër Havës nuk ulem unë. . .

I bënë vend afër Dritës.

U zbrazën dhe sërishmi u mbushën gotat. Hiqja, nëse nuk kishte pirë gjer atëhere, tani i çoi gotat njërën pas tjetrës. Dani shikoi Hiqen, tha: — Folë diçka, Hiqe. Me dorën mbështetur mbi gjoks foli:

«Ç'të flas, or vëlla? Ju po merreni me Havën. . . Por dije, edhe këta të tjerët që po pinë le të dëgjojnë, se Hava ka qenë ajo që ka mbjellë zi për kokën time! Hava është ajo që qysh dymbëdhjetë vjeç, filloi të luante bishtin me atë muhaxherin e mallëkuar, me atë që e mori dhe u zhduk nga dheu. Oh, e dini vetë, Hava u bë lugat dhe ja hëngri kokën babait tonë të mirë! Hava ma mbylli shtëpinë e babait. Hava mbolli helm në zemrat e djemve të mi, i bëri të më braktisin tani në pleqëri! Oh, më leni të kënaqem me dasmën e mbesës sime, pëllumbeshës sime! Mos kërkoni t'ju flas gjë gjersa gjendem nën një kulm me atë që i sollti turpe dhe kobe derës së Cen Rrushit. . . — Kështu foli Hiqja, pastaj nxori shaminë nga brezi dhe filloi t'i fshinte lotët.

Dasmorët u gjendën përpara një gjendje të rën-

dë. Disa bënë sikur s'kishin dëgjuar asgjë, të rinjtë ja shkelnin syrin njëri-tjetrit.

Hava Rrushi, u ngrit më këmbë dhe, mbasi përcolli shikimin te të gjithë, e përçëndroi te Hiqja e tha:

— Pak më parë, duke e parë Dritanin dhe Dritën, tha ajo, — po mendoja. «Kjo dasmë po bëhet tetë muaj pas elektrifikimit të plotë të vendit. Çudi, edhe emrat që mbajnë dhëndrri dhe nusja tregojnë dritën. Në kohën kur jetonim ne, shpeshherë mungonte edhe pisha për t'i ndriçuar qoshet e errëta të kasolles plot blözë. Kisha dëshirë t'ju flisja diçka për atë kohë, po nuk desha t'ju ndërpres këngën. Meqë motra ime, Hiqja, shfreu haptas urrejtjen dhe cmirën kundër meje, më falni që dua t'ju grabis kohën me ca fjalë. E kam vënë re qysh moti qëndrimin e Hiqes, po t'i flisja, e dija se nuk do të më kuptonte. Le të marrë vesh pra motra ime se unë nuk i kam asnjë faj për ato që më ngarkon ajo. Dëgjoni pra:

«Isha tre vjeç kur më kishin blerë për një muškë me misër ata të Bajraktarëve të Ahishtës, pikërisht për Zunin. Kur shkela në të shtatëmbëdhjetat, u njoha fare rastësisht me një djalosh shkollar, Sokol Muhaxheri e quanin, ishte nga Kosova. Meqë babai i Sokolit kishte qenë kryengritës, grabitqarët që ja kishin zaptuar me gjak katundin e tij, e kishin kërkuar për ta vrarë. Ai merr gruan, djalin dhe del në këto anë për të shpëtuar kokën. Sokolit i vdesin prindërit nga malarja, me anën e disa të njohurve futet në strehën vorfnore. Sokoli, verës, për të mbajtur shpirtin me bukë, pajtohej në ndonjë punë. Atë verë erdhi në katundin tonë, u pajtua te beu për të ruajtur dhe ushqyer tre kuaj shale. Mua gjithashtu më pat pajtuar babai si çobaneshë viçash te beu. Në

fillim Sokoli m'u duk i largët, kryelartë. E pandehja ashtu siç i konsideroja bijtë e beut. Por isha gabuar. Shpeshherë më qëlloi që bagëtinë e beut t'i kullosnin bashkë në livadhe.

«Havë, më thotë një ditë Sokoli, përse nuk mëson shkrim e këndim?» Unë e quajta budallallëk atë punë. Po djaloshi ishte këmbëngulës, ma mbushi mendjen dhe ja i hymë punës. Pashë se Sokoli sa ishte i dashur dhe i sjellshëm, aq ishte i rreptë. Më gjërat që m'i mësoi, m'u duk se ishte njeriu më i ditur në botë, bile më i ditur se gjithë myftilerët e rrethit të Tiranës (kështu mendoja atëhere). Djalo-shit ja kisha frikën, se ishte ca si kokëshkretë.

Sokoli më tregoi mbi jetën e vet, edhe unë atij mbi timen.

Erdhi vjeshta me shira, Sokoli shkoi në jetimore. Pranverës tjetër u këthye prapë. Më kishte sjellë libra. Pikërisht atë vit Bajraktarët i dërguan njerëz babait tim që të pregatitej për dasmën.

Një ditë Sokoli më tha se edhe verën tjetër do ta kalonte në çifligun e beut. Unë i tregova se verës tjetër do të isha te burri.

— A e do atë që do ta marrësh për burrë? — më pyeti pa teklif Sokoli. Unë ula kokën dhe nuk u përgjegja, se e tillë pyetje në atë kohë ishte e pazakonshme.

— Domethënë e do — tha Sokoli.

Cila femër mund të pyetej atëhere nëse e donte apo nuk e donte atë që do t'ja jepnin për burrë. Ishte vendosur katërmbëdhjetëvjet përpara. . . Kush kishte vepruar ndryshe që të veproja unë.

— Havë, — tha Sokoli dhe për të parën herë ma vuri dorën nën mjekër — e njeh? . . E do burrin që do të marrësh?

— Përse, u dashka ta duash pa ta marrësh për burrë një tjetër?! — thashë unë e zemëruar.

Sokoli ja plasi të qeshurit. Unë u skuqa gjer të veshët, e mora me mend se fola si budallaqe. Djaloshit, kur më pa në atë gjendje, u mbështet në bërryl, më pa i menduar, pastaj foli:

— Unë kam për të të thënë diçka, por më parë duhet të më thuash e do, apo nuk e do njeriun që do të të japin për burrë...

— Thuaj çfarë do të thuash, pastaj të tregoj unë...

— Jo, pa më thënë ti, unë s'të flas asnjë fjalë...

Ne ishim harruar në bisedë, kur ngritëm kokën, pamë qehajain e beut i cili po vinte drejt nesh duke fshikulluar me kamxhik viçat që kishin hyrë në misrin e beut.

— Mjerë unë, e mjera! — klitha unë e lebetitur, sepse qehaja Maksuti ishte katili i katilave.

— Çfarë ke? — më qërtoi Sokoli. — Ja ku më ka... Burrat maten me burrat!..

— Pa eja këtu, ti, bushtër e Cenit! — bërtiti qehaja Maksuti.

Më dridhej trupi se e dija; ai kamxhik që mban-te në dorë qehajaji do të më dërmonte për vdekje.

Kur fytyrëgjatoshi po afrohej, Sokoli u ngrit, ja zuri rrugën dhe e pyeti:

— Sa ban dami, o Maksut?

— S'kam punë me ty — ja ktheu qehajaji dhe bëri të vinte drejt meje.

— Ku po shkon, or burrë?! — i tha Sokoli dhe e kapi për mënge.

— Ik, mor spurdhjak, — ja ktheu qehajaji duke e shtyrë — ik sa s't'i kam bërë turinjtë si ndonjë domate të shtrydhur!

— Unë spurdhjak! — ja pat Sokoli.

— Po, — i tha qehajai — spurdhjak bile i qelbur!

— Hy, fytyrëgjatosh si pykë qenefi! — ja ktheu Sokoli. Kur qehajai u mat ta qëllonte, djaloshi u përku, pastaj u hodh si shigjetë duke futur kokën në shalët e qehajait. . . Unë mbeta pa mend. Sa hap e mbyll sytë, qehajai u gjet i përmbysur me kokën poshtë. Sokoli si ndonjë ketër kërceu, më mori mua shkopin dhe ja ngjeshi qehajait në kokë, në shpatulla. Pashë se si qehajai si ndonjë dhelpër mbrohej me njërin bërryl, kurse me dorën tjetër në mënyrë tinzare mundohej të nxirrte revolen nga këllëfi. S'di as vetë se si mora një gur aty afër dhe e godita qehaja Maksutin në krah. Goditja që e rëndë. Dora që përpiquej të nxirrte armën ju lëshua pa fuqi. Pastaj t'i hyri Sokoli me shkopin prej shkoze sa që m'u duk se nuk ja la një bri ngjitur. Qehajai u mbulua i tëri në gjak. Ngërdheshi lemërishëm fytyrën sa të çonte krupën.

Edhe në ëndërr të tmerronte rrahja e atij njeriu të beut që aq egër e mizor sillej me bujqërit.

Sokoli e këputi kamxhikun, e lidhi duar e këmbësh qehajain dhe e la si ndonjë thes me byk midis livadhit. Pastaj vrapoi, zuri kalin më të mirë të beut, i hipi:

— Mirë u pafshim! — më tha.

— Po unë! . . . Unë ku të shkoj?! Ku të mbytem unë! — i thashë Sokolit. — Do të shkoj të mbytem në lumë! . . . Sa të më mbytin të tjerët, më mirë. . .

Sokoli e goditi me thembrat e këmbëve kalin, shtrëngoi rripin me të cilin ja kishte lidhur turinjtë, e ktheu nga unë e tha:

— U thuaj se unë e rraha. . . .

— Sa para bëjnë fjalët e mia, o Sokol, ata kanë për të më mbytur. . . .

— Hall me dekë e gjygj me rrnue! — tha Sokoli.
— Havë, unë paç me të marrë me vete, po ti do të marthesh. . . .

— Po, do të marthem me varrin. . . — ja ktheva unë.

Sokoli shikoi rreth e qark livadhet, i zbriti kalit dhe m'u afrua:

— Havë, unë s'kam më vend këtu, se kah do t'ja mbaj, as vetë nuk e di. Po deshe, eja me mua. Tjetër s'kam se ç'të them. . . .

Unë qëndroja si ndonjë hu gardhi. Në atë çast më dukej sikur më ishte boshatisur koka. I zgjata duart drejt Sokolit pa vetëdije:

— Sokol, — i thashë — merrmë edhe mua!

Sokoli më ngriti hopa dhe më hipi mbi kalë, pastaj e afroi kalin te hendeku, hipi dhe vetë dhe i ngrahu. Kali i hazdisur u bë erë. Përmes misrave dolëm te zabeli. . . .»

— Kështu më ngjau — tha Hava dasmorëve që po e dëgjonin me vëmendje — dhe jo siç e tha motra ime, Hiqja.

Sorkadhja tha: — Të lutem, shoqja Havë, e vazhdoni gjer në fund ngjarjen, se është kaq interesante, sa që kam dëshirë të madhe ta dëgjoj.

— Halla Havë, — u lutën shumë zëra të të rinjve dhe të rejave — vazhdo e na folë gjer në fund.»

Hava vazhdoi:

— Siç ju thashë, nga misri dolëm në zabel. Atje Sokoli hoqi xhakëtën dhe e vuri në vend të shalës. Pa këmbyer as edhe një fjalë u futëm në zabel. Kur ju afruam bjeshkëve, atje ku fillonte e përpjeta e thepisor, kali rrëzohet me hundë e me buzë.

— Havë, tash rruga s'është për kalin, jemi larguar boll. Me na kapë, s'na kap kush — tha Sokoli duke zbritur nga kali. Më zbriti edhe mua përdhe; ja hoqi rripin kalit, e goditi vitheve e kali u kthye nga kishim ardhur. Ne ju ngjitëm kërshit përpjetë. Nata na zuri majë mali.

Sokoli tha: — Havë, ulu e pusho, jemi të lodhur, nesër do të kemi udhë të gjat. Natën do ta kalojmë këtu.

Disa hapa më tutje nesh ngrihej një shkëmb tjetër, i cili përkulej duke lënë nën gjoksin e tij një guvë të stërmadhe. Djaloshi u ndal aty. Kur pashë se po mundohej të ngrinte peshë një gur, vrapova. E mbërthyem të dy dhe e rrokullisëm. Hoqëm edhe shumë gurë të tjerë.

— Tashti ulu — tha Sokoli. Pastaj doli jashtë, u kacavir nëpër drunj, theu degë dushqesh, solli një vandak, edhe një vandak tjetër. E shtroi vendin mirë dhe sërishmi u zhdruk në pyll.

Kur po më mbërthente ankthi i pritjes në errësirë, djaloshi u kthye me një trung të trashë që mbante mbi sup. E lëshoi përdhe, pastaj me të rrokullisur e hodhi në mes të shtrojes së pregatitur me dushqe.

— Në njërën anë të trungut do të fle unë, — tha ai — në anën tjetër bjerë ti. Zgjidh vendin, shtrihu, se duhet të çlodhemi.

— Shqetësimi, me të cilin e prisja kalimin e asaj nate, iku. U shtriva në dushqe. Sokoli përtej trungut ma hodhi xhaketën e vet.

— Mbulohu, — tha ai — se je fill në këmishë. Nata bën ftohtë në mal.

U mbulova, po gjumi kishte marrë aratinë. Që

përtej trungut dëgjohej frymëmarja e Sokolit. E ngarkoja veten me faj ndaj tij.

As më kishte shkuar ndër mend se në këmbën time te Bajraktarët do të çonin Hiqen dhe do të vdiste babai.

S'kaloi as gjysmë ore. Një rraptimë ngjethëse në guvë. U ngrita e tmerruar. Sokoli brofi në këmbë:

— Hy, ju marrtë dreqi! — mallëkoi ai, pastaj u ul. — U tute, Havë? — më pyeti. — Janë pëllumbat e egër, i ndoqi skifteri, ja aty në atë zgavër janë futur. I shpëtuan rrezikut. . .

Mora frymë e qetësuar.

— Fli, — më tha Sokoli — mos u tut, jam unë këtu. Sapo mbylla sytë dhe u përpoqa të flija, m'u duk sikur dëgjova zërin e babait:

«Ah, Havë, Havë, ç'më bëre! S'më mjaftonin hallet e tjera, zhveshur e zbathur, pa një kore bukë. . . Po edhe kjo m'u desh! Ku të mbytem unë tashiti!» M'u bë sikur nëna e sëmure hapte krahët në errësirën e kasolles dhe më kërkonte. Hapa sytë dhe pata frikë t'i mbyllja më. «Ç'do të bëjë Durgut Bajraktari? Sigurisht do t'i gjejë një nuse tjetër Zunit, mendoja unë dhe mendimet e natës i ngjajnë errësirës, janë plot agushi mbytëse, frymëmarrëse.» Mos më vrasin babain, thashë me vete, ndoshta Danin e vogël. . . E përse? Ata s'u kanë ndonjë faj! . . Eh, ne femrat, siç thoshte nëna, përse lindim! Më mirë të mos na pritnin kërkthizën fare, as të mos na e lidhnin, se sa jetojmë në varr për së gjalli». Kështu mendova atë natë ndarjeje, atë natë ankthi.

Ca klithma zogjsh grabitqarë ma rrëqethnin mishin. Vonë më zuri gjumi.

Pastaj filluan ëndrrat dhe nuk di se cilat ishin më të llahtarshme, ëndrrat apo mendimet.

Në të zbardhur mëngjezi, Sokoli më preku me një degëz dushku, duket më kishte thirrur, e unë nuk kisha dëgjuar. Brofa në këmbë.

— Nisemi — tha djaloshi.

Ecëm gjatë. Kaluam lugina, përrenj, pyje të egra pa asnjë shenjë jete... Tek-tuk pamë ndonjë kasolle të vetmuar.

Një kullë rrëzë një shpati, kurse njerëz asgjë-kundi.

Kur po i ngjiteshim një të përpjete, takuam dy malësorë të vegjël me rroba të grisura fije-fije.

— A keni shkrepse, o trima? — i pyeti ata So-Sokoli.

Njëri nga vogëlushët ja ktheu me pyetje:

— Ç'a ajo që kërkon, mor mik?

— Asosh që ndizet zjarr — ja ktheu Sokoli.

— Oh, or tungjatjeta! — foli vocërraku, — Të nezme kërkoke ti, asosh mban vetëm kulla e Col Shpatit, ne nuk e lemë me u shue zjarri në votër.

— A keni gja për me hangër, o trima? — i pyeti Sokoli.

— Qe besa burrë na korite. Nji kore bukë e ke-na, po e ndajmë përgjysëm — tha malësori i vogël. Futi dorën në trastë, nxori që andej një copë bukë misri, e kapi në të dy cepat, e goditi në një majë guri, copën ma të madhe ja shtriu Sokolit.

— Na fal, or mik, se lala nuk ka ardhë prej pazari, se do të sjellë misër. — Fjalën e fundit e tha me njëfarë krenarie dhe gëzimi. — Nuk do ju kishim lëshue me kaq... Hajt udhë e mbarë! E mira goftë me ju!

Ishim të uritur. E brejtëm pjesë-pjesë atë copë bukë të fortë misri të pjekur në prush. Sikur na erdhën fuqitë. Por, kur pimë ujë në një gurrë, na

preu uria dhe më keq se më parë. U futëm prapë në pyll, Sokoli herë pas here hapte kaçubat e dëllinjave. Gjeti çerdhe zogjsh, morëm vezë, i thyenim dhe i pinim. Hëngrëm llastare dhe gjethe dushqesh...

Gjatë rrugës takuam një udhëtar të çuditshëm, i cili na shikoi me vërejtje dhe na pyeti:

— Nga ju kemi e nga udhë e mbarë kështu?

— Jemi nga Mali i Bardhë, — gënjeu Sokoli — motrën e kam sëmurë, e po e çoj në kishën e Shënanoit...

— A mos ju ka rënë në sy një grua me një burrë në rrugën tuaj? — pyeti udhëtari.

— Jo, besa — ja preu shkurt Sokoli dhe vazhduam udhëtimin.

Udhëtari i misterëshëm disa herë u ndal dhe na shikoi nga prapa. Pastaj shpejtoi hapin nga kishim ardhur ne.

— Duhet të jetë njeri i Durgut Bajraktarit — tha Sokoli. Dielli është në të perënduar, ne duhet të ecim gjithë natën, ndryshe...

Prapë udhë pa krye, pyll pa udhë. Mëngjezi zbardhi mbi disa kodra. Ishte një mëngjez i mugët. Rrezet e diellit përthyeshin mbi drurët e egër, të braktisur. Asnjë zhurmë, përveç ndonjë klithme të ndonjë grifshe. Trungjet e thara e të kalbura siç i kishte rrëzuar era, dergjeshin si kufoma nëpër rrëpira. Një avull bojë hiri në të bardhë ngrihej me përtim nga dheu. Luginat e mbuluara nga mjegulla dukeshin nga sipër si liqenjtë të çuditshëm.

U ngjitëm majë një kodre, poshtë saj dukej një rrafshinë e verdhë në të murme. Sokoli vuri dorën si strehë:

— Erdhëm — tha ai. Në zërin e tij ndjehej gëzim. Zbritëm kodrës, në fund të saj. Midis disa rra-

pash të gjatë e me degë të shkapërderdhura gjendej një shtëpi e vetmuar. Sokoli trokiti në portën e shtëpisë së rrethuar me mure.

... — Kush a në derë? — pyeti një grua nga frengjia.

— Jam Sokoli i Din Kosovës, hape derën.

Pas pak kërciti shuli nga brenda, u hap dera, dy burra të gjatë me mustaqe gjer te veshi u përshëndetën me Sokolin. U habitën kur më panë dhe mua me të.

— Oj fisnike, — më tha njëri nga ata — ti shko ke fëmijët. — Pastaj thirri:

— Oj Nifë, dil e prit mysafiren!

Atje e mora veten mirë, po me Sokolin shiheshim shumë rrallë, mos të them fare, sepse ai qëndronte në odën e burrave, kurse unë me garinë.

Burrat rropateshin tërë ditën në tokën e bajraktarëve si çifçi që ishin, kurse gratë të mbyllura, ndonjëra gatuante bukë misri, ndonjë tjetër armonte teshat e cuklosura, e zonja e shtëpisë për çdo ditë kujdesej për groshën në vorbë. Nifa, vajzë tetëmbëdhjet vjeç, verbohej duke bërë çorape e gjergjef. Ishte trupselvi, me ato vetulla hark, me buzët të kuqe, të kuqe si petale trëndafili, me gërshetin që i lëshohej dy pëllëmbë nën bel. Më desh pa masë. Po tërë kohën që qëndrova në shtëpinë e tyre, Nifja çdo ditë e qëndiste gjergjefin me lajle dhe me lot. Mora vesh se ajo atë vit marotohej. Ma tha me gojën e vet, po megjithëse asnjëherë nuk më foli për brengën, kunnata më e vogël e saj më tregoi se asaj i kishin dhënë për burrë një të ve që merrej me shitblerjen e kuajve, të cilit gruaja e parë i kishte lënë pesë fëmijë. Sa herë e shikoja Nifen, ndjeja përbrenda një zemërim kundër padrejtësisë që i ishte bërë.

Pas dy javësh, një pasdarke, Nifja më përqafoi dhe më tha:

— Do të të them diçka, po mos i thuaj kujt. I përgjova burrat në odë. Sonte do të niseni me Sokolin, se Durgut Bajraktari ka shpërndarë trimat kahmos, ju kërkojnë... Ne jemi muhaxhirë në tokë të Durgut Bajraktarit, ba me u prish edhe me të, s'kemi se ku mbytemi!.. Ti, Havë, më hyre fort më qejf, ta kam lakmi... Kenke trimneshë, kështu duhej të isha edhe unë, po pa pas krahë, nuk fluturohet. Ju do të shkoni, mos u bani merak, sa mban rruga një ditë e një natë, do t'ju përcjellin burrat tanë... Pastaj... Ah, të kem të vij edhe unë me ju, të takohem me dadën Shotë, vetëm asaj mund t'ja hapja zemrën, vetëm ajo mund të ma shëronte plagën që ka me më shti në varr... .

— Oj Nifë! Nifë, moj! — u dëgjua zëri i një burri.

— Folë, bacë! — u përgjegj Nifa.

— Thuaj asaj fisnikes të përgatitet për rrugë, jepja opangat e tua e krjet çar i duhet për një udhë të gjatë! —

Më veshën e më mbathën mirë. Më dhanë në dorë edhe një bohçe plot, po se ç'kishte brenda, nuk dija. Kur dolëm, edhe pse ishte natë, vura re se Sokoli ishte i armatosur. Dy burra, vëllezërit e Nifes, na përcollën atë natë dhe të nesërmen gjithë ditën. Në mbrëmjen tjetër, si u ndamë prej tyre, Sokoli më pyeti:

— Havë, ku do të shkojmë?

— Ç'më pyet, o Sokol, prapa diellit, më ke edhe mua prapa... — i thashë unë.

— Të lumtë! Do të shkojmë në malet e Kosovës,

do të bashkohemi me çetat e Shota Galicës... Dada Shotë do të gëzohet kur të shohë...

— Kush është ajo?

— Hej hej! A s'paske dëgjue për Shota Galicën, a?!

— Harrova, më ke folë ti, më ka folë dhe Nifa, e bija e atyre muhaxhirëve... A është shumë larg?

— Larg sa të dësh! Po të armatosur jemi, veshë e mbathë jemi! Kam një mendim, nëse më dëgjon?

— Thuaje.

— Sikur të vishesh me rroba burrash... Se rrugë e gjatë, male e rrugë të mbushura me lloj-lloj njerëzish....

— Ku t'i marr robat e burrave pa?!

— I ke në bohçe.

— E pse të vishem si burrë?

— Të thashë përse... Ashtu është ma mirë...

U vesh. Më lindi një dëshirë ta shikoja vetem se si dukesh. Me flokët e kisha punën pisk. Kisha vënë qeleshe, po gërshetat më arrinin gjer në brez.

— Këtyre gërshetave ç't'u bëj, o Sokol?

— Boll për qejf i kam, në zemër më pikon, po më parë duhet rrejtur kryet, se, kur e ke kryet, flokët dalin papë.

— Me se t'i shkurtoj?

Sokoli nxori thikën e tha:

— Merre thikën, i shkurto vetë si të mundësh.

I shkurtova flokët ashtu si munda. Ngjanim si dy moshatarë, që, pa i ra brisk fytyrës, jeta e rëndë i ka detyruar të burrërohen përpara kohe.

Pas njëzet ditë udhëtimi, të lodhur e të uritur, të reckosur pyjeve e shkrepave, arritëm atje për ku ishim nisur.

Gjithshka mund të harroj, po fytyrën e Shota

Galicës kurrë. Ajo nuk bënte dallavere fjalësh. Si na pa, mori vesh për hallin tonë, ja shtrëngoi dorën Sokolit, i ra me grusht dashmirësisht në gjoks dhe i tha:

— Kam ndigjue se babai yt, baca Din, ka dekë, vetë shëndoshë! Të gjithë do të vdesim. Jeta asht dhurata ma e madhe për njerëzit. Duhet luftue për ta rregullue atë... Kjo punë mund të arrihet vetëm me tytën e pushkës. Tjetri s'ta fal kot asnji cigare duhan, lirinë kurrë! Kush mendon ndryshe ose ju kanë krymbë trutë, ose asht tradhëtar! Liria fitohet vetëm me luftë, me luftë e me gjak!.. — Pastaj m'u kthye mua:

— Thonë se gratë janë vetëm për shpi, me qepë; me pjekë bukë, me ba gjellë e me rritë fëmijë... Kështu thonë!.. Po kush më tepër se nanat asht e interesueme për lirinë e truallit, se pa vatan nuk rriten fëmijë! (Mori zjarr, në fytyrën e saj pashë forcën e gruas). Kush guxon t'ja ndalojë nanës luftën! Nanës që rrit fëmijë i lypset të luftojë për lirinë e pjellës së vet! Ne, motër, jemi forcë e madhe, pa ne nuk mund të mendohet jeta, as puna, as lumtunia. Do të vijë dita, do të lindë edhe për ne gratë një diell i madh. Ti mos u skuq, unë, kur thashë se gruaja duhet të luftojë, nuk thashë se ajo nuk duhet të martohet, po të martohet ashtu qysh ja don e bardha zemër, si unë, si ti. Lypset të bëjmë fëmijë, se jeta është natë shterpë pa fëmijë. Se Shqipnisë i duhen luftarë dhe punëtorë. . Të gjitha femnat ndryjnë në zemrat e tyne andrrat e dëshirave të tyne të shkelmueme qysh në mugullim. Nuk besoj se ka pas grue pa zemër të zhbirueme nga plagët. Të gjitha ato që dergjen nëpër vorre kanë marrë me vete andrrat e burgueme, të dështueme, vuajtjet skllavnuese. Ko-

hët kanë sjellë skllavni për popuj të ndryshëm, lakmi dhe shfrytëzim për grupe njerëzish, sundues dhe të sunduar, kurse në të gjithë botën, për të gjitha femnat kohnat kanë sjellë vetëm shtypje dhe mjerim. Havë motër, ja në këtë krahnorin tim prej femne veshun me rroba burrash jeton një shpresë e madhe, e cila më jep forcë, më trimnon, më mbush me jetë. Unë mund të vritem, a të vdes, po mbaje mend fjalën që ta them. Kjo shpresë që ruaj në gjini në një të ardhme ka me u kthye në diçka që shihet, që jetohe dhe lumohet... Nëpër këtë truall arbnoor kanë kaluar shumë zaptues, po të gjithë kanë thyer qafën, e kanë hangër rrashtën e vet, kurse shqiptari ka mbetur i pastër, i fortë, i pathyeshëm. Dije se nga gjini i këtij populli, i cili dijtë me e rruajtë qenjen e vet gjatë gjithë rrebeshëve, kanë me lindë bij që ëndrrat tona t'i bajnë realitet.

Kështu më foli Shota Galica atëhere dhe pas tetëmbëdhjet vjetësh vërtet u bënë realitet ëndrrat e saj.

Qëndrova dy vjet me çetat kryengritëse të udhëhequra nga Shota. Luftuam në Lypovec e në Mikunqicë, në Galicë e gjer në Obrije. Atje në mal e midis luftarëve dhe pushkëve u martova me Sokolin. Shota Galica në vend të kurorës së nusërisë në kokë më vuri një gjerdan fishekësh dhe uroi:

«Me pushkë dhe luftë për bashkimin e çifteve në jetën bashkëshortore me dëshira dhe të drejta të barabarta!» Mbarimi i urimit u shoqërua me dhjetë të shtëna armësh.

Për dy vjet pashë dhe mësova shumë nga dada Shotë. Ajo ishte e urtë, e butë dhe gojëmjaltë me mikun, por e çartur dhe e tmerrshme ndaj armikut.

Kohët rrodhën shpejt si një lumë i rrëmbyer

në një vjeshtë me stuhi. Mizëri ushtrish sulmonin çetat që udhëhiqte Shota Galica. Ajo u plagos rëndë në kraharor, po trupi i saj i kalitur në beteja duroi. Përpara se të lëshonte çerdhen e dashur, malet ku luftoi, thirri shumë veta, bisedoi goja-gojës me ta. Më thirri edhe mua e më tha:

«Për dy vjet besoj se ke mësuar se si duhet luftuar! Gjithmonë si mjet i vetëm për të fituar lirinë dhe të drejtat janë armët. . . Këtë mos e harro kurrë!»

Unë dhe Sokoli morëm rrugën e zezë të mërgimit. U sorollatëm nëpër botë më tepër pa bukë se me të, sepse duhej të mbronim jetën tonë, dashurinë tonë. Mjerimin më së miri mund ta njohë ai që bredh rrugëve të botës, gjithmonë i përbuzur, pa asnjë mbrojtje. Nëpër botë pamë shumë bashkatdhetarë, të cilët i kishte shtyrë varfëria dhe mjerimi ta linin truallin. Të cfilitur bridhnin andej-këtej për një kafshatë. . . Ndonjë mbytte mjerimin në gotën e rakisë; më vonë e gjenin të vdekur në ndonjë qorrsokak.

Më lindën fëmijë, por në belbëzimet e para atyre ju ngri buzëqeshja, vdiqën nga skamja dhe uria.

Kur bulevardet u nxinë nga paradat e këmishëve të zeza, kur kryqi i thyer rrokullisej dhe përmbyste piramida kufish, si në ndonjë natë të ngarkuar me re pis të zeza, rrufeja gjëmimtare me dritën e saj verbuese ndriçoi shtigjet dhe monopatet, ajo paralajmëronte rrebeshe të stuhishme. . .

Në bodrumin ku flinim, — trokitje. E hapëm portën; thirrje. Partia Komuniste Shqiptare thërriste Shqiptarët e ndershëm që të ktheheshin në atdhe.

Këto fjalë tingëlluan ashtu siç tringëllin krisma e këputjes së litarit të trekëmbëshit në qafën e atij që pret të ekzekutohet.

Pas dy muajsh u gjetëm në malet e Atdheut, u bashkuam me çetat partizane.

Im shoq, Sokoli, luftoi si i çartur. Ai u vra gjatë Ofensivës së dimrit. Ra ashtu si u ka hije trimave komunistë.

Sokoli ra për lirinë e Shqipërisë, për lirinë e vegjëlisë, për lirinë e Lavdies që kurrë të mos e merrte kush nëpër këmbë atë dhe shoqet e saj.

Ne vazhduam betejën. Luftuam dhe fituam. Lavdia u rrit dhe u ushqye me racionin partizan. Ajosot është një luftare e së resë.

Lavdia pat dëshirë të madhe të vinte në dasmën e kushërirës së vet, por ndodhet me shërbim në Sarandë...

Më falni, se ndoshta u zgjata...»

* * *

Orkestra kumboi. Të gjithë këndonin.

Hiqja, e strukur midis Dritës dhe Zijait, qante. Zemra e saj e mpirë dhe e helmatisur nga intrigat e Zunit të Bajraktarëve, u shkrifërua.

Buzët i lëviznin, po ajo s'po nxirrte asnjë fjalë. Mbërtheu gotën me raki, e ktheu, përshkoi dorën eshtake buzëve e foli si ndër ethe:

— Unë, unë... mësova shumë nga ime motër. Havën gjer më sot e kam pandehur armiken time më të madhe. Krejt ndryshe ma pat spjeguar dhe ndër-syer Zuni i Bajraktarëve... Të falemnderit, Havë! Gjithë jetën qenkam gënjyer!.. Ma bëni hallall...

Dan Rrushi tha: — Unë e dija që ishe gënjyer, por s'dija ç'të bëja. Fjalët tona të dukeshin të hi-

dhura. Po gëzohem që më në fund... Gëzuar, pra, ta çojmë dhe nga një gotë.

Hiqja, e hutuar, shikonte gjithë ato fytyra të qeshura të dasmorëve dhe ju duk sikur i shkriu një copë akull që kishte në gjoks.

Sakaq në derë u dukën tre djemtë e Hiqes!

— Nënë, — thanë ata — do të vish me ne.

Ashtu e ngashëryer Hiqja përqafoi me mall të bijtë.

Drita ja shtrëngoi dorën Dritanit ndërsa gjaku i vërshoi në fytyrë.

Redaktor: PANDELI KOÇI

Kopertina nga: SVETLLANA STRAZIMIRI

Tirazhi 6000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISM. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»

Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1972